



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.11.2021, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka– kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”.

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Aurora Mara, Elda Hoti, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati, Alqi Bllako, Jurgis Çyrbja, Ermonela Valikaj(Felaj), Dhurata Tyli, Bardhyl Kollcaku dhe Fatmir Xhafaj,

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Damian Gjiknuri, dhe Erisa Xhixho,

Të ftuar:

Delina Ibrahimaj – Ministre e Ekonomisë dhe Financave

Mimoza Dhëmbi – Drejtoreshë e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit

Gentian Opre - Drejtor i Analizave dhe Programimit Buxhetor

Fran Brahimi - Drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Ferhati - Mirëdita!

Përshëndetje të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e komisionit të ligjeve, datë 3 nëntor 2021.

Sot, sipas njoftimeve dhe kalendarit përkatës, në rendin e ditës kemi shqyrtimin dhe miratimi në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe do të veprojmë sipas kalendarit të miratuar në mbledhjen e mëparshme. Ndërkohë, relatorë janë zoti Alqi Bllako dhe Klevis Xhoxhi. Për prezantimin në parim janë ftuar dhe kanë konfirmuar pjesëmarrjen ministria e Ekonomisë dhe Financave, zonja Delina Ibrahimaj, mirë se erdhët zonja Ministre, e shoqëror nga zonja Mimoza Dhëmbi, mirë se erdhët, zonja Dhëmbi, drejtoreshë e Përgjithshme, Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit, Gentian Opre, drejtor i Analizave dhe Programimit Buxhetor dhe zoti Fran Brahimi, drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore. Zoti Opre, zoti Ibrahim, mirë se keni ardhur në komision!

Pa humbur kohë, ia kaloj fjalën ministres të bëjë një prezantim të projektligjit. Duke qenes e jemi në diskutimin në parim, menjëherë pas zonjës ministre fjalën do ta marrin relatorët.

Faleminderit, zonja Ministre!

Fjala për ju.

Delina Ibrahimaj- Përshëndetje të gjithëve!

E nderuara kryetare e Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në funksion të prezantimit të projektbuxhetit 2022 të paraqes një përmbledhje të shkurtër të politikave dhe reformave të ndërmarra nga qeveria që prej vitit 2013 e deri tani për të kuptuar ecurinë e ekonomisë, problematikat e mundshme dhe potencialet për tu zhvilluar në vijim.

Ekonomia shqiptare ka njohur rritje të vazhdueshme që prej vitit 2013, kur nisëm qeverisjen. Të dhënat tregojnë se në vitin 2013 rritja ekonomike ka qenë 1%, ndërkohë që ka njohur rritje progresive, duke arritur deri në 4,07% në vitin 2018. Për shkak të tërmetit dhe më pas pandemisë globale të COVID 19, ekonomia u ngadalësua, por gjithsesi performoi më mirë sesa ishin të gjitha parashikimet tona dhe të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Për vitin 2020, institucionet ndërkombëtare si FMN, Bankë Botërore, Komisioni Evropian, BERZH e të tjerë parashikuan një recesion deri në 9%, ndërkohë që u regjistrua zyrtarisht vetëm 3,96%.

Projektbuxheti i vitit 2022, që keni në dispozicion për shqyrtim, ka si objektiv primar konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike pas përballimit me sukses të dy fatkeqësive natyrore, që goditën vendin tonë në mënyrë të njëpasnjëshme. Ky objektiv madhor bazohet në pritshmëritë pozitive të qeverisë për një rritje ekonomike domethënëse në vitin 2021 prej 7,6%, duke lënë pas recesionin ekonomik të vitit 2020, prej 4%.

Falë reformave dhe politikave të duhura që u ndërmorën, ekonomia arriti të rikthehej në norma të larta rritje, ku, specifikisht, për vitin 2022 parashikojmë një rritje të ekonomisë me 4,1%, duke mbajtur një nivel mesatar prej mbi 4% për vitet pasuese 2023 dhe 2024. Më lejoni të theksoj që këto parashikime janë në linjë me parashikimet e FMN-së.

Rritja ekonomike na ka mundësuar që të mbështesim qytetarët, duke rritur mirëqenien e tyre dhe të ardhurat e disponueshme. Të dhënat tregojnë se rritja ekonomike ka qenë me bazë të gjerë. PBB-ja për banor është rritur nga 466 mijë lekë në vitin 2013, në 568 mijë lekë në vitin 2020 dhe pritet që në vitin 2022 të shkojë 661 mijë lekë për banor.

Falë politikave dhe reformave të ndërmarra në ekonomi që prej vitit 2013, treguesit kryesorë që kanë lidhje me mirëqenien e qytetarëve kanë pësuar përmirësim të vazhdueshëm. Kështu, papunësia ka pësuar rënie, ajo ka qenë në nivelet e 16,4% në vitin 2013 dhe ka zbritur në 11,6% në vitin 2019, ndërkohë që për vitin 2022 pritet të zbresë në 10,3%.

Të ardhurat totale në buxhetin e shtetit kanë njohur rritje të fortë falë politikës së duhur fiskale dhe miradministrimit fiskal. Në vitin 2013, të ardhurat ishin në nivelin e 327 miliardë lekëve ose sa 24,8% e PPB-së. Ato kanë pësuar rritje deri në 460 miliardë lekë, ose sa 27,4% e GDP-së në vitin 2019. Të ardhurat totale pritet të arrijnë në 484 miliardë lekë këtë vitin 2021 ose sa 28,8% e PBB-së dhe parashikohen në 536,8 miliardë lekë në vitin 2022. Në rritje kanë qenë edhe shpenzimet buxhetore për të mbështetur rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore në shërbim të qytetarëve. Në vitin 2013 shpenzimet buxhetore kanë qenë 394 miliardë lekë, ose sa 29,2% e GDP-së. Ato kanë arritur në 29,3% të GDP-së në vitin 2019.

Investimet publike kanë njohur rritje të vazhdueshme, si për mbështetjen e punësimit, ashtu edhe për rritjen ekonomike. Në vitin 2013, shpenzimet kapitale kanë qenë në vlerën 65 miliardë lekë, ose sa 4,8% e GDP-së, si dhe kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2020 shpenzimet kapitale arritën në 102 miliardë lekë, ose sa 6,3% e GDP-së, duke përfshirë fondin e rindërtimit. Në vitin 2021 investimet publike shënuan 121 miliardë lekë ose 7,2% e GDP-së, duke qenë një stimul i fortë për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe gjenerimin e punësimit.

Borxhi publik ka qenë sa 70,4% e GDP-së në vitin 2013 dhe qeveria ka ndjekur një politikë të fortë për uljen e tij dhe në vitin 2019, borxhi zbriti në 66,3% të GDP-së, por u rrit për shkak të pandemisë dhe mbështetjes që qeveria u dha qytetarëve dhe bizneseve me dy paketat fiskale deri në masën 80%, e cila pritet në fund të 2021.

Për të mbështetur qytetarët dhe për të nxitur shtimin e të ardhurave të disponueshme qeveria ka rritur vazhdimisht pagën minimale. Në vitin 2013, paga minimale ka qenë rreth 22 mijë lekë, por ajo ka pësuar rritje të vazhdueshme gjatë viteve në vijim, për të arritur në 30 mijë lekë që është aktualisht. Rritja e fundit e pagës minimale u bë në vitin 2021. Rritje ka pësuar edhe paga mesatare, ku në vitin 2014 ajo ka qenë 45961 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021.

Ekonomia shqiptare ka pasur një rikuperim të shpejtë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 dhe në këtë periudhë ajo ka shënuar një rritje prej rreth 11,9%. Ky rikuperim mbështetet në një sërë faktorësh dhe duket se ka një shpërndarje të gjerë në dimensionin sektorial të ekonomisë. Reduktimi i kufizimeve pas rënies së infektiveve, ku një rol kyç ka pasur edhe procesi vaksinimit, rritja e besimit të biznesit e konsumatorit: përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale e monetare çuan në rritje të konsumit të familjeve shqiptare, të investimeve publike e private, si dhe në rritje të eksporteve.

Për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik ne ju paraqesim projektbuxhetin për vitin 2022. Ky është buxheti më i madh në historinë e shtetit shqiptar. Ky dokument i rëndësishëm fokusohet në prioritetet kryesore si: vijimi i reformave strukturore për të garantuar rritje ekonomike dhe punësim; mbështetje të shtresave në nevojë; rritje e produktivitetit; forcimi i shtetit ligjor; digjitalizimi i ekonomisë, si dhe investimet kyçe në infrastrukturë.

Lidhur me objektivin për forcimin e shtetit ligjor, projektbuxheti i paraqitur mbështet objektivat kryesore, që janë: funksionalizimi i organeve të reja të drejtësisë; përmirësimi i kuadrit ligjor dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi; zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin; reformimi i shërbimeve publike dhe rritja e efikasitetit të tyre; ndërmarrja e masave konkrete për një reformim legjislativ, institucional dhe strukturor për të gjithë ato institucione ligjzbatuese, që mundësojnë që shqiptarët të marrin shërbime ligjore në kohë, sa më cilësore, profesionale dhe në mënyrë dinjitoze; përmirësimi i sistemit të ndihmës juridike falas që çdo qytetar në pamundësi financiare dhe grupet në nevojë të përfitojnë nga ky shërbim në mënyrë cilësore; reformimi i sistemit penitenciar në tërësi, menaxhimit efektiv të institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe rritja e profesionalizimit dhe integritetit të stafit të burgjeve, si ai policor dhe ai

civil; përmirësimi i shërbimit të provës për monitorimin e zbatimit të dënimeve alternative me një staf profesional dhe me integritet; përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit.

Mbështetja me prioritet e reformës në drejtësi. Që nga viti 2016, kur kjo reformë është institucionalizuar dhe po vijon të japë rezultatet e saj, nga buxheti i shtetit janë rritur financimet në mbështetje të institucioneve të kësaj reforme. Për institucionet e sistemit të drejtësisë në vitin 2016 parashikohej një buxhet që zinte 1,6% të shpenzimeve totale të institucioneve buxhetore, e thënë ndryshe, buxheti i institucioneve të reformës ishte në masën 4,28 miliardë lekë dhe një staf prej 2345 punonjës gjithsej. Në buxhetin e vitit 2022 parashikohet që financimi i shpenzimeve të këtyre institucioneve zë 2,3% të totalit të shpenzimeve buxhetore, duke akomoduar një fond prej 8,4 miliardë lekë dhe personel prej 3322 punonjës. Pra, në 6 vjet, pas miratimit të paketës ligjore të reformës në drejtësi, në buxhetin e vitit 2022 reflektohet një rritje me 196%, ose, pothuajse, dyfishimi i fondeve të parashikuara në hapat e parë të këtij procesi. Gjithashtu, në buxhetin e vitit 2022 parashikohet edhe financimi i shtesës së personelit në masën 42%, krahasuar me vitin 2016. Buxheti i sipërcituar i vitit 2022 ka akomoduar kostot vjetore të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë njëkohësisht edhe financimin e politikave të reja të miratuara për SPAK dhe BKH si dhe financimin e plotë të Institucioneve të rivlerësimit kalimtar të magistratit. Projektbuxheti i vitit 2022 vazhdon të mbështesë me prioritet reformën në drejtësi. Kështu që nga viti 2016, kur kjo reformë është institucionalizuar dhe po vijon të japë rezultatet e saj, nga buxheti i shtetit janë rritur financimet në mbështetje të institucioneve të kësaj reforme. Për institucionet e sistemit të drejtësisë në vitin 2016 parashikohej një buxhet që zinte 1,6% të PPB-së, ndërkohë që sot është 2,3%.

Në fund të fjalës sime dua të ndalem te buxheti i pushtetit vendor për vitin 2022. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për shkak të pasojave të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19 janë një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore. Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë dhe reformat e ndërmarra deri më tani, të cilat pritet të kenë impaktin më të madh në organizimin e administratës publike vendore në funksion të rritjes së cilësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2022 janë parashikuar në masën 59,7 miliardë lekë, me një rritje prej 3,3% më shumë se i pritshmi i vitit 2021. Këto shpenzime për vitin 2022 zënë 3,2% të PBB-së, nga 2,3% që zinin në vitin 2013.

Me qëllim ruajtjen e stabilitetit të shpenzimeve vendore dhe për mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për përballimin e shpenzimeve të COVID-19, niveli i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2022 do të jetë rreth 250 milionë lekë më i lartë se viti 2021. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 është llogaritur 18,7 miliardë lekë, të cilës do t'i shtohen edhe fondet prej 8,75 miliardë lekë, transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor. Si rrjedhojë, në vitin 2022 granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 27,45 miliardë lekë.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe uroj që ju ta miratoni projektbuxhetin që ju paraqitet!

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjala për relatorin, zotin Bllako.

Alqi Bllako - E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar kolegë,

E nderuara zonja Ministre dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave,

Projektligji Për buxhetin e vitit 2022” është propozim i Këshillit të Ministrave në bazë të neneve 78, 81, pika 1, neni 83, pika 1, dhe neni 158 i Kushtetutës.

Ky projektligj i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Të nderuar kolegë,

Buxheti i vitit 2022 vjen në një moment kur vendi ka hyrë në një trajektore të shëndetshme të rritjes ekonomike, pas recesionit të vitit 2020 si rezultat i dy goditjeve të njëpasnjëshme, që ishte tërmeti i nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia globale e COVID 19.

Mitigimi i efekteve negative të këtyre dy goditjeve në kushtet e uljes ndjeshëm të të ardhurave, vazhdimit të investimeve të nevojshme, si dhe nevojës për investime dhe shpenzime shtesë, që lidhen kryesisht me procesin e rindërtimit, apo menaxhimit të pandemisë diktuan një rritje të menjëhershme të borxhit publik. Pavarësisht këtyre dy goditjeve, falë masave të marra, përgjatë 6-mujotrit të parë të vitit 2021 PPB-ja shënoi një rritje prej 11,9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5,4% e PPB-së duke shënuar një ulje me 1,4% në raport me deficitin e pritshëm të vitit 2021. Gjithashtu, edhe borxhi publik do t'i rikthehet një

trajektore rënëse duke filluar që nga vitit 2022, ku pritet të bjerë në rreth 78,9% e PPB-së në raport me të pritshmen 80% të vitit 2021.

Në vitin 2022 të ardhurat totale, siç edhe ministrja e përmendi, janë planifikuar të arrijnë në 536.8 miliardë lekë, me një rritje gati 7,8% krahasuar me të pritshmin e vitit 2021. Ndërkohë që 93 % e të ardhurave totale të planifikuara janë nga zëri i të ardhurave tatimore.

Sa i përket nivelit të shpenzimeve të parashikuara për vitin 2022, ato janë në nivelin 637,6 miliardë lekë, ose 34,1% e PBB-së.

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore për tre vjetët në vijim do të mbështetet në një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqendruar në procesin e rindërtimit, si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike.

Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, të cilat, së bashku, garantojnë stimuj pozitivë për rritjen ekonomike të vendit, duke gjeneruar njëkohësisht punësim.

Nëse do t'i gruponim tre prioritetet kryesore të buxhetit, siç ministrja i përmendi, ato janë: shërbimet ndaj qytetarëve dhe sipërmarrjeve, digjitalizimi, si dhe investimet kyçe në infrastrukturë.

Ndërkohë që ministrja në fjalën e saj detajoi risitë që lidhen me secilën prej këtyre prioritetëve kryesore, unë po ndalem shkurtimisht te financimi i disa reformave që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni. Në këtë prizëm një aspekt i rëndësishëm për t'u përmendur është: mbështetja financiare e reformës në drejtësi, e cila ka synim të përgjithshëm krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur dhe profesional. Për reformën në drejtësi që prej vitit 2016 qeveria shqiptare ka shpenzuar rreth 4,45 miliardë lekë, një reformë e rëndësishme, e cila do të ndihmojë në mënyrë të padiskutueshme edhe zhvillimin ekonomik afatmesëm. Në vitin 2021 kjo reformë u mbështet me 7,7 miliardë lekë dhe 668 personel shtesë për institucionet e drejtësisë, ndërkohë që kjo mbështetje për vitin 2022 pritet të rritet në nivelin e 8,4 miliardë lekë, ose me një rritje prej 0,7 miliardë lekë të rinj. Rritjen më të madhe të shpenzimeve buxhetore në krahasim me vitin 2021 për institucionet e drejtësisë e ka SPAK, me një rritje me 509 milionë lekë, ose gati dyfishim të fondit për këtë institucion, e ndjekur nga KLGJ-ja me një rritje me 186 milionë lekë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Rritje të shpenzimeve buxhetore është planifikuar dhe për një sërë institucionesh të tjera të pavarura, të cilat do të raportojnë në këtë komision, siç janë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Avokatit i Popullit.

Në vijim të reformës administrativo territoriale janë bërë reforma të rëndësishme në drejtim të menaxhimit financiar në nivel vendor. Rritja e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ka bërë të mundur që të rriten me mbi 3 herë investimet shërbimet publike dhe, njëkohësisht, të rritet në mënyrë të qenësishme pesha e buxhetit vendor. Kështu, shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2022 janë parashikuar në nivelin e 59,7 miliardë lekë, ose 3,25 i PPB-së, duke shënuar përgjatë këtij 8-vjecari një rritje 0,9% nga niveli i 2,3% që ky shpenzim ishte në vitin 2013.

Në këto 8 vjet rezulton se të ardhurat vendore kanë pësuar një rritje në vlerë absolute, pre 16,8 miliardë lekë, ndërkohë që transferta e pakushtëzuar për pushtetin vendor është rritur në masën 54%.

Siç ministrja e përmendi, kjo transfertës e pakushtëzuar për vitin 2022, do të ketë një rritje prej 250 milionë lekë, krahasimisht me parashikimin e vitit 2021. Në transfertën e pakushtëzuar, përveç vlerës prej 18,7 miliardë lekë, do të shtohet edhe fondi prej 8,75 miliardë lekë transfertës e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja transferuar në nivel vendor.

Granti total nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor do të jetë në shumën 27,45 miliardë lekë.

Në përfundim, pa dashur të zgjatëm shumë, ju kërkoj të nderuar kolegë, të votojmë në parim pro këtij projektligji, si dhe në mbledhjet e ardhshme, ku do të kemi mundësi të shqyrtojmë më në detaje zërat e buxhetit, të mundemi që me objektivitet të dëgjojmë dhe trajtojmë të gjitha kërkesat që mund të vijnë nga institucionet e drejtësisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka- Faleminderit, zoti Bllako!

Është momenti, ku mund t'i bëjmë pyetje ministres dhe pastaj do të kalojmë në diskutime. Kush ka pyetje për ministren sa i takon prezantimit në parim të projektbuxhetit? Zoti Mediu, zoti Alibeaj dhe zoti Xhoxhi.

Fillojmë me zotin Mediu, pastaj me të gjithë kolegët.

Fatmir Mediu- Zonja Ministre, ka dy zëra në shpenzimet e buxhetit, të cilat kanë të bëjnë me të përndjekurit politikë dhe me pronarët. Ka pasur ndër vite një fond, rreth 3 miliardë, për pronarët, prandaj dua të di sa është disbursuar dhe sa planifikohet të disbursohet në këtë vit buxhetor dhe, me një analizë tuajën, për sa kohë mund të mbyllet ky kompensim i pronarëve? Ka edhe vendime të Gjykatës së Strasburgut që detyrojnë qeverinë shqiptare që të paguhen pronarët, sa është planifikuar dhe sa do t'u jepet pronarëve legjitimë si rezultat i këtyre vendimeve të Gjykatës së Strasburgut?

Kam edhe të njëjtën pyetje për pronarët politikë. Për sa vite mendoni që me këtë planifikim buxhetor për të përndjekurit politikë do të mbyllet kompensimi i tyre, duke pasur në konsideratë faktin që ky grup shoqëror, i cili ka vuajtur në diktaturë si asnjë pjesë tjetër e shoqërisë, në pjesë e madhe e tyre janë sot në një moshë shumë të thyer, ose një pjesë e tyre nuk jetojnë më?

Pyetja tjetër ka të bëjë me buxhetin e mbrojtjes, zonja Ministre. Dua të deklaroj që në fillim që jam absolutisht në mbështetje të ngritjes së buxhetit të mbrojtjes për të kapur objektivin 2%, i cili, dua të sjell në kujtesë të kolegëve, ka qenë një objektivi për t'u realizuar brenda vitit 2010, është realizuar vetëm një herë, në nivel 2021, në vitin 2008 dhe pastaj ka rënë në nivele drastike. Për të vazhduar me pyetjen, më specifikisht dua të them se në buxhetin e mbrojtjes ju keni parashikuar që pensionet e ushtarakëve të përfshihen në buxhetin e mbrojtjes në një kohë që këto janë pjesë e politikave sociale, po ashtu edhe spitali ushtarak, emergjencat civile. Sa përqind të buxhetit zënë këto zëra në raport me investimet në mbrojtje për rritjen e nivelit operacional, sepse flasim për Forcat e Armatosura, të cilat duhet të kenë një nivel operacional në përputhje me standardet e NATO-s, pavarësisht nga vështirësitë që kanë dalë vitet e fundit nga COVID apo probleme të tjera?

Mua më bën përshtypje edhe përfshirja e spitalit ushtarak këtu, sepse nuk ka më spital ushtarak, spitali i traumës, që ka qenë spital ushtarak, në dijeninë time mund të jem edhe gabim, ka kaluar si institucion pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe nga pikëpamja e funksionalitetit është në një nivel shumë të ulët në shërbim të ushtarakëve në raport me atë që u shërben civilëve. Kjo ka të bëjë edhe me atë që ka kërkuar Ministria e Mbrojtjes. Prandaj, unë mendoj se do të kishte nevojë për një gjykim më të thellë sesa thjesht planifikim i zërave në politikën e mbrojtjes, duke e konsideruar rritjen e nivelit operacional me mjete që i shërbejnë Forcave të Armatosura, duke filluar nga ato tokësoret, ajroret dhe detare. Kostot më të mëdha të buxhetit, në dijeninë tim, shkojnë thjesht në mirëmbajtje, pa realizuar ndonjë nivel të kënaqshëm operacional, gjë që vjen për shkak të shumëllojshmërisë që kanë këto mjete dhe pamundësisë për t'i mirëmbajtur, pra, do të ishte më mirë nga ana e qeverisë të gjykohej që të analizonte një unifikim të këtyre mjeteve për të realizuar një nivel më afatgjatë operacional, njëkohësisht, të mirëmbajtjes së tyre. Këto pyetje kisha.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Mediu!

Zonja Ministre, fjala për ju për përgjigjet.

Delina Ibrahimaj – Atëherë, për sa i përket pyetjes së parë të fondit të kompensimit të pronarëve, është planifikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm një shumë prej 5 miliardë lekësh, ndërkohë që në planin e vitit 2021 janë 3 miliardë lekë, pra ka një shtesë në këtë fond.

Për sa u përket vendimeve të Strasburgut, më lejoni të theksoj se pjesë e projektbuxhetit dhe e tabelave shoqëruese janë edhe një sërë vendimesh, të cilat për çështje teknike ende nuk janë ezauruar, por për çështje transparence dhe për çështje të marrjes në konsideratë në hartimin e buxhetit të shtetit dhe të marrjes në konsideratë të risqeve që ka buxheti i shtetit Ministria e Financave i publikon dhe i merr parasysh në drejtim të risqeve.

Për sa i përket...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne për vitin 2021 kemi disbursuar deri tani 1,6 miliardë lekë nga 3 që ishte i parashikuar për 9-mujorin.

Për sa i përket çështjes së të përndjekurve politikë, ndër vite ne kemi alokuar fonde dhe vazhdojmë të alokojmë fonde për të kompensuar të përndjekurit politikë. Për vitin 2022 fondi i alokuar është 1 miliard lekë, ndërkohë që dua të theksoj se të gjithë ata ish-të përndjekur politikë, që janë të gjallë tashmë, janë kompensuar dhe pjesa e ngelur mbetet për familjet e atyre që kanë qenë të përndjekur politikë, të cilat planifikohen dhe do të planifikohen për t'u paguar në të ardhmen.

Më lejoni të rikthesoj se gjatë 2 vjetëve të fundit buxheti i shtetit ka qenë shumë i presuar nga pandemia dhe nga tërmeti dhe, sigurisht, të gjitha shpenzimet dhe fondet e tjera kanë hasur diferenca për shkak të pagesave që qeverisë i është dashur të bëjë në mbrojtje të ndihmës ekonomike, në mbrojtje të punësuarve dhe në mbrojtje të stabilitetit ekonomik total.

Për sa i përket buxhetit të mbrojtjes, për vitin 2022 ne kemi parashikuar një rritje të konsiderueshme të këtij buxheti dhe dua të theksoj se në projektbuxhetin afatmesëm, pra të viteve 2023-2024 ne planifikojmë që, sipas marrëveshjes që kemi, të arrijmë nivelin 2% në vitin 2024. Për vitin 2022 niveli që do të arrihet është 1,75% GDP-së, i cili është totalisht në linjë me planifikimet që ne kemi bërë dhe kemi diskutuar edhe herë të tjera që dalëngadalë do të shkojë në 2%

Për sa u përket zërave në buxhetin e mbrojtjes, spitali ushtarak që ju përmendët ka qenë gjithmonë pjesë e buxhetit të mbrojtjes. Patjetër që emergjencat civile janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së mbrojtjes, ndërkohë në buxhetin, që ju paraqitet për miratim, kemi të parashikuar fonde të konsiderueshme për ngritjen e një akademie të mbrojtjes në stilin e akademisë *West Point*; kemi të parashikuar ngritjen dhe jetësimin e projektit “*Cyber Security*”, që shkon për mbrojtjen dhe për sigurinë kombëtare në linjë me të gjithë praktikat

më të mira ndërkombëtare dhe të gjithë zërat e investimeve janë pjesë e tabelave të buxhetit që ju i keni në dispozicion dhe mund t'u referoheni.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Xhoxhi, keni pyetje?

Klevis Xhoxhi - Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kisha dy pyetje për zonjën ministre.

Së pari, a keni parashikuar mekanizma, procese ndryshe apo shtesë kundrejt atyre që keni përdorur deri më sot për monitorimin e performancës së bashkive, përdorimin e fondeve të buxhetit, specifikisht në dy fushat e vëmendjes janë mbetjet urbane dhe ujësjellës-kanalizimet?

Në kushtet e agravimit apo të tejzgjatjes së krizës energjetike, a është menduar për zgjatje të afatit të garancisë sovrane?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zonja Ministre, keni fjalën për përgjigjen.

Delina Ibrahimaj – Ministria e Financave dhe Ekonomisë patjetër që ka një sistem, i cili monitoron buxhetet dhe respektimin e ligjeve të buxheteve vendore.

Për sa u takon ujësjellës-kanalizimeve gjatë 2 vjetëve të fundit ne kemi ndërmarrë një nismë për investimin në ujësjellës-kanalizime, të cilat përbëjnë edhe një pjesë të konsiderueshme të buxhetit që ju është paraqitur për vitin 2022. Pra, synohet që ky shërbim, i cili është jetik, nëpërmjet investimeve që kanë filluar në 170 ujësjellës të përmirësohet ndjeshëm.

Për sa i përket ecurisë së këtyre ujësjellësve, sigurisht do të ketë një vëmendje të shtuar të ministrisë sonë, por edhe të strukturave që i monitorojnë, në mënyrë që përdorimi i fondeve të buxhetit të jetë sa më eficient dhe të kontrollohet që të mos shkojmë në abuzime me këto fonde.

Për sa i përket garancisë së energjisë, ne kemi sjellë një akt normativ për vitin 2021, ku parashikojmë të kemi një garanci sovrane në vlerën 10 miliardë lekë për mbështetjen e sektorit të energjisë për import. Nëpërmjet kësaj mbështetjeje do të garantohet që çmimi nuk do të rritet për asnjë qytetar, për asnjë biznes të vogël. Pra, nuk do të ketë presion për rritjen e çmimeve në jetën e qytetarëve, por do të mbështetet nëpërmjet garancisë sovrane. Edhe për vitin 2022 në projektbuxhet është parashikuar një fond prej 8-miliardë lekësh, i cili shkon për këtë mburojë ndaj krizës globale të energjisë elektrike.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, ka pyetje.

Enkelejd Alibeaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëmëngjesi, zonja Ministre!

Zonja Ministre, do të mundohem që pyetjet t'i bëj të qarta dhe të kuptueshme dhe, eventualisht, do të prisja që edhe përgjigjet të ishin të fokusuar në thelbin pyetjes, sepse kam disa pyetje.

Ju dhe relatorët i kushtuat një peshë të madhe sistemit të drejtësisë. Fjala kyç është do të shtohet mbështetja financiare.

Pyetja e parë: a keni parashikuar ju në lidhje me KLGJ-në dhe KLP-në, pra Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë i Prokurorisë, shtesë fondi për vitin 2022, për shkak se, sipas parashikimeve kushtetuese atyre, u shtohet një aksion ligjor që është zhvillimi i vetingut; nëse po, sa?

Pyetja e dytë: thatë se keni dyfishuar mbështetjen financiare për SPAK-un, a mund të dimë cila ka qenë arsyeja dhe justifikimi për këtë dyfishim të mbështetjes financiare për SPAK-un? Keni bërë shumë mirë, por duhet të dimë arsyet thelbësore pse ka ndodhur ky dyfishim.

Pyetja e tretë: KLGJ-ja ka filluar punën dhe nuk dihet se në çfarë faze është në lidhje me hartën, e cila, sipas legjendës urbane, sepse deri tani është legjendë urbane, thuhet se mund të suprimojë një sërë gjykatash të shkallës së parë, madje edhe apelesh në shndërrimin e tyre në një të vetme në Republikën. Mund të mos jem i saktë, për sa kohë që nuk ka transparencë, por, meqenëse ju jeni këtu, çdo lëvizje e tillë, suprimim organesh sjell eventualisht efekt në buxhet. A keni parashikuar gjë ju në lidhje me këtë ngjarje të pritshme?

Pyetja tjetër në lidhje me Avokaturën e Shtetit, në fakt, jo me Avokaturën e Shtetit se sa me atë punë që merret Avokatura e Shtetit, që bëhet fjalë për Arbitrazhin, që është në shtesë të asaj që tha zoti Mediu, për Gjykatën e Strasburgut. Që të qartësohemi për publikun Gjykata e Strasburgut është tjetër gjë, Arbitrazhi tjetër gjë, se unë e di që ju e dini. Sipas informacionit që unë kam, janë të paktën 6 çështje në Arbitrazhin Ndërkombëtar; disa prej tyre kanë përfunduar, disa janë, siç thuhet në këto raste, pezull. Kanë përfunduar çështja e mirënjohur tani e Beketit dhe një çështje tjetër “*Valeria Italia S.R.L.*”. Tek e para përlllogaritja që është bërë, të paktën nga vendimi është 108 milionë euro, plus edhe kostot e avokatisë apo të ankimit në apel. Ndërkohë, për tjetrën, që ka përfunduar tashmë, bëhet fjalë për 550 mijë euro. Janë edhe katër çështje të tjera: “*Actor-Copri*”, pretendimi i të cilëve është 45 milionë euro; “*Dondi & Kubota*” 90 milionë euro; “*Arka Energy*”, pretendimi i të cilëve është 110

milionë euro; “Durrës Kurum–Shipping” 100 milionë euro, pra në totalin e tyre janë 450 milionë euro.

Pyetje: çfarë keni parashikuar ju në lidhje me detyrimin për t’i paguar këto vendime të gjykatave të Arbitrazhit; sa, nëse po, dhe kur, nëse po, në lidhje kjo me Avokaturën e Shtetit?

Në vijim të pyetjes së zotit Mediu në lidhje me shpërblimin e ish-të përndjekurve dhe të pronarëve, ju thatë për të përndjekurit janë vendosur 1 miliard lekë. Pyetja që zoti Mediu bëri, dhe ju nuk ju përgjigjet dot, ndoshta për harresë, por po e ribëj është: me këto ritme 1 miliard lekë për të përndjekurit...

Së dyti, me 5 miliardë lekë për pronarët a keni bërë ju një parashikim se për sa vite në të ardhmen do të mundet shteti shqiptar t’i shpërblejë dhe t’i dëmshpërblejë të përndjekurit dhe pronarët?

Më rezulton se nga projektbuxheti ju keni parashikuar 13 PPP. A mund ta di cilat janë këto 13 PPP-të. A kanë këto një emër, një objekt se për çfarë bëhet fjalë?

Së fundi, në buxhet keni parashikuar që për dy nga PPP-të e përfunduara tashmë (në fakt, bëhet fjalë për dy inceneratorët e Elbasanit dhe Fierit) në totalin e tyre në vitin 2022 do t’u jepni 18 milionë euro; për Elbasanin do ta bëjnë pyetjen deputetët e Elbasanit; unë po pyes për Fierin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kujtoj që në vitin 2020, pra vitin e kaluar, diku nga shtatori Kryeministri Rama, atëherë kur plasi çështja e inceneratorëve për Fierin, tha publikisht: “Në dhjetor të vitit 2020 ka përfunduar ineneratori i Fierit dhe do të fillojë nga puna një nga planet më të mëdha që ka ai qytet.” Në përfundim kushdo kupton se e gjithë ajo para e destinuar është dhënë, dhe jo vetëm është dhënë, por edhe është ndërtuar; jo vetëm është ndërtuar, por është edhe në funksion; jo vetëm është në funksion, por ka filluar nga puna efektive. Në fakt, dy muaj më parë u dogjën plehrat e Fierit, u helmuan i gjithë Fieri dhe Lushnjë. Ndërkohë që rezulton se në buxhetin që ju keni prezantuar, keni parashikuar 18 milionë euro të tjerë, besoj një pjesë e tyre edhe për inceneratorin e Fierit. Dua të di: sa janë këto para të tjera shtesë që gllabëron inceneratori i Fierit, djeg para, jo plehra, dhe cila është arsyeja, për sa kohë që Kryeministri ka thënë se ka përfunduar investimi ? Për çfarë jepen këto, për çfarë kërkesë? A mund ta di, apo jo?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zonja Ministre, keni fjalën për përgjigje.

Delina Ibrahimaj – Në lidhje me pyetjen e parë për sa u përket institucioneve të KLGJ-së dhe KLP-së, ne për organet e vetingut, duke qenë se nuk kemi një kërkesë zyrtare

për përfundimin e proceseve, kemi parashikuar të njëjtin buxhet që kishim parashikuar për gjithë vitin. Pra, nuk është parashikuar buxhet i reduktuar për organet e vetingut. Në momentin që Ministrisë së Financave do t'i vijë një kërkesë për rialokimin e këtyre fondeve, këto fonde do të rialokohen në KLGJ dhe në KLP. Pra, buxheti, i cili është i parashikuar, është aty dhe do të prekë gjithë vitin.

Për sa i përket dyfishimit të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kam kohën shumë të reduktuar, sepse duhet të shkoj në një komision tjetër. Prandaj, dua t'i ezauroj të gjithë përgjigjet e sakta dhe të shkurta.

Enkelejd Alibeaj – Pra, KLGJ-ja dhe KLP-ja për vitin 2022 për detyrën që ato kanë të parashikuar nga Kushtetuta, nuk ka të parashikuar asnjë shtesë. Pyetja vetme e vetme që kam.

Delina Ibrahimaj – Ka parashikuar shtesa. Pra, përveç shtesës së organeve për vetingun, siç thashë, nëse do të vazhdojë të funksionojë sistemi i vetingut siç është, ka të alokuar një fond që mbështet shpenzimet me ngarkesën që ka për të gjithë vitin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër.

Nëse proceset do të ndërpriten dhe do të kalojnë në KLGJ dhe në KLP, ato fonde do t'u rialokohen këtyre dy institucioneve. Përveç kësaj, ka edhe një shtesë në ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – Ju lutem, kolegë, dëgjoni përgjigjet e ministres dhe mund ta merrni përsëri fjalën për saktësim, sepse, nëse flet edhe ministrja, edhe ju, nuk kemi dot saktësi dhe qartësi. Të nderuar kolegë, ju lutem të dëgjojmë ministren dhe të mos e bëjmë bashkëbisedim. Ministrja të japë përgjigjet dhe merreni përsëri fjalën për saktësime.

Zonja Ministre, përgjigjuni, se është radha juaj.

Delina Ibrahimaj – Pra, për sa i përket dyfishimit të buxhetit për SPAK-un, kryesisht ka lidhje me kërkesat që kanë ardhur për plotësimin e strukturës së BKH-së.

Për sa i përket pyetjes për hartën gjyqësore, ne ende nuk kemi një kërkesë zyrtare për këtë proces. Dua të theksoj se ne jemi Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe merremi me financimin dhe me koston, pra funksionojmë në bazë të kërkesave zyrtare dhe jo në bazë të fjalëve.

Për sa u përket proceseve të Arbitrazhit, ne me transparencë totale kemi të publikuara të gjitha rastet, të cilat janë në Arbitrazh. Është Avokatura e Shtetit institucioni, i cili merret me procedurat e Arbitrazhit, dhe, në përfundim të procedurave totale të të gjithë atyre

rasteve që ju përmendët, i drejtohet Ministrisë së Financave me shkresë, në mënyrë që të iniciohet pagesa. Arsyeja pse ne i publikojmë këto vendime, të cilat janë në proces dhe arsyeja pse ne i kemi pjesë të projektbuxhetit si kontigjencë, janë pikërisht për përgjegjshmërinë e Ministrisë së Financave që, në rast se do të materializohet 1, 2 apo 3 apo do të përfundojë në total procesi i Arbitrazhit, t'i përfshijë në buxhet në momentin më të parë.

E njëjta gjë vlen.

Enkelejd Alibeaj – Pra, i keni parashikuar, apo jo?

Delina Ibrahimaj – Pra, këto janë praktika buxhetore, të cilat mbahen, publikohen dhe parashikohen si kontigjencë nga Ministria e Financave, me qëllim që, nëse do të materializohet një vendim përfundimtar dhe nëse procedurat ligjore do të përfundojnë totalisht, atëherë ne e kemi kapacitetin financiar nëpërmjet kontigjencës që të fillojmë pagesat e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E njëjta gjë vlen për proceset...

Klotilda Bushka – Zonja Ministre, vazhdoni me përgjigjet.

Zoti Alibeaj, ju lutem, mbajini pyetjet për më vonë!

Delina Ibrahimaj – Unë u shpreha qartë, duhet të ketë kërkesa zyrtare nga institucione të tjera që të konfirmojnë që procedurat kanë përfunduar totalisht. Ne nuk funksionojmë me fjalë, por funksionojmë me shkresa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Për sa u përket PPP-ve dhe koncesioneve, janë 13 koncesione, të cilat janë të parashikuara me mbështetje buxhetore për vitin 2022, janë të publikuara dhe janë brenda paketës së projektbuxhetit që ju keni përpara, në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, por i keni brenda tabelave tuaja. Pra, janë brenda paketës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk janë tonat, por të shtetit, të Ministrisë së Financave. Vijnë në Kuvend për t'u miratuar dhe vijnë si paketë totale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, janë trembëdhjetë koncesione, siç e thashë edhe një herë, është tabela numër 1, faqja 50 e materialit, i cili ju është vënë në dispozicion. Në total, pagesat për koncesionet për vitin 2022 janë të parashikuara në vlerën 13, 8 miliardë lekë. Ndërkohë, në vitin 2021, i pritshmi për këto pagesa është 14, 5 miliardë lekë.

Pra, fondet e buxhetit të shtetit që do të shkojnë për pagesat e koncesioneve, në vitin 2022 janë më të ulëta se sa ato të vitit 2021. Ndërkohë, në tabelën 1, faqja 50 i keni të detajuara me pagesa për çdo koncesion.

Për sa u përket pagesave për fondin e pronarëve dhe ish-të përndjekurve politikë, ne mundohemi maksimalisht që këto pagesa të përfundojnë së shlyeri në një kohë sa më të parë. Historiku ka treguar, siç thashë, që për pjesën e pronarëve në vitin 2021 janë parashikuar 3 miliardë lekë, ndërkohë që për vitin 2022 janë parashikuar 5 miliardë lekë.

Pra, në linjë me hapësirat buxhetore, në linjë me detyrimet, ne mundohemi që këto fonde t'i alokojmë në masën e duhur, me qëllim që të mos kemi projeksione në lidhje me kohën se kur do të përfundojmë, por të mundohemi të ezaurojmë sa më shumë të jetë e mundur brenda hapësirave buxhetore.

Për sa u përket të përndjekurve politikë, e ritheksoj se fondi i parashikuar është 1 miliard lekë. Gjatë dy vjetëve të fundit kemi pasur një presion të jashtëzakonshëm për të përballuar krizat e njëpasnjëshme që kemi kaluar. I kemi kaluar me sukses. Sot jemi në një moment kur rritja ekonomike është dyshifrore, kjo pikërisht falë politikave fiskale dhe politikave ekonomike që kemi ndërmarrë. Do të marrim parasysh të gjitha kërkesat për rritjen e këtij fondi në të ardhmen, kur situata ekonomike të jetë e stabilizuar.

Unë do t'ju kërkoj ndjesë, dhe zëvendësministri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Jo, zonja Ministre, jeni këtu deri në orën 11. 30, sipas rakordimeve me Ministrinë e Ekonomisë. Pastaj mund të zëvendësoheni.

Delina Ibrahimaj – Më duhet të shkoj te Komisioni i Arsimit, i cili është në pritje që unë të shkoj.

Klotilda Bushka – Atëherë më falni, zonja Ministre, por a mundet të mbarojmë me pyetjet e zonjës Felaj dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, do ta vendosim ne, kolegë, se çfarë do të bëjmë. Zonja ministre mund të largohet, por do të jetë zëvendësministri përkatës ai që do të na japë përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Ju lutem, kolegë, një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të respektoni njëri-tjetrin, në radhë të parë?

Zonja Ministre, ju mund të largoheni për te komisioni tjetër. Ne do të rakordojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, sepse ne kemi rakorduar me komisionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Sula, se do ta zgjidhim edhe për procedurë. Do të vazhdojmë me pyetjet deri në orën 11. 30 e pastaj do të vendosim së bashku, nëse do ta ndërpresim për të pritur ministren apo do të vazhdojmë me zëvendësministrin.

Ju lutem! Zonja Felaj ka kërkuar fjalën për pyetje.

Enkelejd Alibeaj – Zonja Ministre!

Dashnor Sula – Kryetare, e kam kërkuar fjalën për procedurë.

Zonja Felaj, fjala për pyetje.

Enkelejd Alibeaj – Zonja Ministre!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dashnor Sula – E kam kërkuar fjalën për procedurë. Ndërpritet direkt, ky është rregulli i Rregullores.

Zoti Sula, mos i humbisni minutat për procedurë, se të gjithë do të keni mundësi të flisni. T'i japim mundësi edhe ministres, edhe kolegëve, që të bëjnë pyetje e përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Felaj, më falni!

Enkelejd Alibeaj – O Dashi!

Klotilda Bushka – Zoti Sula kërkon fjalën për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndize pra mikrofonin!

Zoti Alibeaj, koordinohuni me zotin Sula, sepse keni dy kërkesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Zonja Ministre, ju thashë të mbanit shënim të gjitha pyetjet.

Klotilda Bushka – Zonja Ministre, zoti Alibeaj, në përgjigje të pyetjeve tuaja, ka nevojë për një sqarim.

Enkelejd Alibeaj – Nënqeshja juaj, zonja Ministre, tregon jo seriozitet.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, lërimi ironitë, ju lutem dhe vazhdoni me çështjen!

Enkelejd Alibeaj – Madje, ju thashë të mbanit shënim edhe pyetjen. I keni ezauruar përgjigjet e pyetjeve të mia? Sepse më rezulton që të paktën një të as që e keni cekur fare. E mbani mend?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Më falni, por nuk kemi nevojë për kaq shumë hartime, kur themi: zoti Alibeaj ka një pretendim, që nuk i keni kthyer përgjigje një pyetjeje. Merreni fjalën dhe kthejani. S'keni nevojë për kaq shumë teatër.

Vazhdoni zonja Ministre!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahimaj – Atëherë, për sa u përket koncesioneve, unë e ktheva përgjigjen. Të gjitha parashikimet buxhetore, për të gjitha koncesionet, janë të paraqitura në tabela, që ju i keni në dispozicion, të cilat janë publike në faqen e Kuvendit. Kjo është arsyeja pse unë e ezaurova pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, të lutem, unë po i kthej përgjigje me respekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket inceneratorit të Fierit, shpenzimet buxhetore të parashikuara për vitin 2022 janë 630 milionë lekë. Më të ulëta se ato të vitit 2021.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Zonja Felaj, radha për pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zonja Ministre, unë kam një pyetje më bazike se sa pyetja për koncesionet, që në fakt janë të gjitha të njohura dhe të gjitha në shërbim të qytetarëve, për shëndetin, për rrugët, për të gjithë çfarë ata presin nga qeveria si përgjegjësi e saj.

Unë desha të dija: cilat janë kategoritë e punonjësve, të cilët do të përfitojnë pagë të rritur, sipas buxhetit të vitit 2022, dhe cilat do të jenë kategoritë e brishta, që do të përfitojnë ndihmë të shtuar nëpërmjet këtij buxheti?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, zonja Ministre!

Delina Ibrahimaj – Në buxhetin e vitit 2022 janë parashikuar rritje të fondit të pagave për arsimin, për shëndetësinë, për mbrojtjen, dhe për disa kategori të Policisë së Shtetit. Janë parashikuar rritje të pagave për punonjësit e burgjeve, si dhe disa alokime për institucionet e drejtësisë.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Ndize mikrofonin!

Ermonela Felaj – Po e shtypa në moment.

Pra, vijimi i pyetjes ishte edhe për kategoritë që janë në nevojë, ato me aftësi të kufizuar, me ndihmë ekonomike. Po për këtë pjesë, çfarë parashikohet?

Delina Ibrahimaj – Për sa i përket ndihmës ekonomike, në projektbuxhetin që e keni përpara për miratim, është parashikuar rritje me 10 % e ndihmës ekonomike për të gjithë përfituesit. Është parashikuar dyfishimi i ndihmës ekonomike për të gjitha familjet që kanë më shumë se tre fëmijë. Është parashikuar trefishimi i ndihmës ekonomike për gratë e dhunuara e të trafikuar, si dhe trefishimi i ndihmës ekonomike për fëmijët jetimë.

Fjala për zonjën Dhurata Çupi.

Dhurata Çupi – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Faleminderit zonja Ministre!

Keni parashikuar 900 milionë lekë për Teatrin Kombëtar, pra për t'ia kaluar bashkisë Tiranë. Ndërkohë, ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që rrezon të gjitha procedurat normative të miratuara nga ju deri më tani.

Kjo do të thotë se ju jeni kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese? Njëra pyetje kjo.

Pyetje tjetër: Kryeministri deklaroi se Rruga e Arbrit inaugurohet brenda vitit 2021. Pra, i bie që buxheti i vitit 2022 të vihet në funksion që nga janari. Thuhet, por asnjëherë s'e kemi parë, që në kontratë do të vendoset taksa 4 euro për dibranët që do të kalojnë në Rrugën e Arbrit. Pra, a e keni parashikuar? Qytetari do të paguajë 4 euro që të vijë në Tiranë dhe 4 euro të shkojë në Dibër, ndërkohë që flasim për qarkun më të varfër të Shqipërisë. A është parashikuar në buxhetin e vitit 2022 kjo taksë vendosur dibranëve?

Pyetje tjetër: Sipas një raporti të Avokatit të Popullit, minimumi jetik është 171 mijë lekë të vjetra. Në vijim të pyetjes që bëri zonja Felaj, pyetja ime është: sa është raporti midis ndihmës ekonomike që jepet sot dhe minimumit jetik?

Pyetje tjetër: 18 miliardë lekë janë parashikuar për zyra, makina dhe mobilje për qeveritarët, ndërkohë që janë parashikuar 1 miliard lekë për ish-të përndjekurit politikë. Cila ka qenë analiza që keni bërë ju në këtë parashikim?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, zonja Ministre përgjigjet.

Delina Ibrahimaj – Atëherë, sa i takon teatrit, ne kemi alokuar shumën që u përmend, pra 900 milionë lekë në buxhetin e Ministrisë së Kulturës, shumë që do të shkojë për ndërtimin e kësaj veprë madhorë.

Për sa i përket Rrugës së Arbrit, unë e theksova edhe në përgjigjet e mëparshme: ne jemi Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ne nuk bazohemi as në fjalë, as në gazeta, as në medie. Ne bazohemi në kërkesa, të cilat janë zyrtare. Kjo kërkesë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për këtë kërkesë, aktualisht nuk ka asnjë parashikim buxhetor. Ne e kemi të parashikuar. Ky është në koncesion, ne e kemi të parashikuar pagesën e këtij koncesioni në bazë të dokumentacioneve që kemi aktualisht në dispozicion dhe në bazë të kontratës koncesionare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhurata Çupi – Po pra, kontrata koncesionare a e parashikon tarifën 4 euro?

Delina Ibrahimaj – Unë e ktheva përgjigjen time.

Për sa i përket minimumit jetik, nuk ka asnjë shifër zyrtare për minimumin jetik...

Dhurata Çupi – E ka Avokati i Popullit.

Delina Ibrahimaj – Avokati i Popullit nuk është institucion, i cili...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, më lini të kthej përgjigje.

Avokati i Popullit nuk është institucion, i cili boton statistika zyrtare. Nuk ka asnjë shifër zyrtare për minimumin jetik, në dijeninë time, dhe unë jam eksperte e kësaj fushe. Pra, nuk ekziston dhe nuk mund të bëjmë raporte mbi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Delina Ibrahimaj – E kam lexuar edhe unë raportin e Avokatit të Shtetit, dhe nuk ka një definicion zyrtar për minimumin jetik.

Më falni, se unë duhet të largohem!

Klotilda Bushka – Zonja Ministre, jeni e lirë të shkoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se do të vazhdojë mbledhja me zëvendësministrin përkatës, dhe do të qëndrojë drejtoresha e Përgjithshme e Buxhetit, zonja Dhëmbi, e cila është në komision sa herë që flasim për buxhetin. Zëvendësministri të zërë vendin.

Delina Ibrahimaj – Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Ministre!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Dhëmbi, ju lutem njoftoni zëvendësministrin të paraqitet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Dhëmbi, njoftoni zëvendësministrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kemi zotin Qefalia, që ka kërkuar fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sula.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Qefalia, mund ta bëni pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Xhemal Qefalia – Shiko, këtu kemi përfaqësues nga Ministria e Financave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Atëherë do të presim pesë minuta.

Pesë minuta pushim, sa të paraqitet zëvendësministri, sa të zbresë nga mbledhja e komisionit të medias dhe të vijë këtu.

Faleminderit!

(Pas pushimit)

Klotilda Bushka – Kolegë rifillojmë mbledhjen e komisionit, të cilën e ndërpreme për 5 minuta. Është paraqitur zëvendësministri i Ekonomisë dhe Financave.

Mirë se erdhët!

E lamë te pyetjet e zotit Qefalia.

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia- Faleminderit!

Unë do të ndalem te çështjet për të cilat pyeti edhe zoti Mediu. Është e vërtetë që buxheti për Forcat e Armatosura është një kërkesë, e cila është vendosur edhe në Samitin e Uellsit për të shkuar në 2%. Është një progres që është bërë nga viti në vit nga qeverisja socialiste dhe ky buxhet nga 1,2 ka shkuar në 1,6, në vitin 2021 dhe është 1,75. Pyetjen e kam konkrete për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave: në këtë buxhet për Ministrinë e Mbrojtjes a do të ketë rritje pagash për ushtarakët? Nëse po, sa për qind do t'u rritet?

Klotilda Bushka – Po, zoti Kadiu.

Besart Kadiu- Faleminderit!

Ashtu siç edhe ju thoni, buxheti i Forcave të Armatosura objektivin e ka të qartë 2% të PPB-së. Sa i përket pyetjes suaj për pagat e ushtarakëve do t'ia jap fjalën zonjës Mimoza Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Sa i përket buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, siç u tha, ne kemi alokuar fondin e nevojshëm sipas marrëveshjes që kemi për të arritur në 2% në vitin 2024. Brenda këtij buxheti është parashikuar edhe një rritje e pagave të personelit ushtarak, që, siç

dihet, është në nivele të vlerësuara dhe do të ketë një rritje të konsiderueshme. Ne kemi parashikuar 30%, por e diferencuar sipas kategorive, rëndësisë, strukturave, reparteve.

Klotilda Bushka – Zoti Sula, keni fjalën.

Dashnor Sula – Ministria është personi politik që udhëheq, çfarë thotë ministria bëjnë zëvendësministrat, të vazhdojmë tani.

Pyetja për Ministrinë e Financave lidhet me inceneratorët, duke pasur parasysh edhe shqetësimin e madh që ka Kryeministri për problemin e mbeturinave dhe mbajtjeve urbane në territorin e Shqipërisë, madje thotë se do t'ua marrë edhe bashkitë kryetarëve që i drejtojnë për shkak të problemit të madh të plehrave. Meqë është i shqetësuar dhe thotë se do t'i monitorojë me satelitët, Albania 1, Albania 2 dhe Arnaut, sepse në Turqi do t'i marrë satelitët, tani pyetja ime lidhet inceneratorin e Elbasanit, sepse sipas informacionit që kam unë dhe problematikave të qarkut të Elbasanit, ky incenerator ka një kapacitet të caktuar mbi bazën e të cilit duhet të funksionojë. Gjithashtu, bashkitë e Peqinit, Belshit, Gramshit, Librazhdit dhe të Përrenjasit e kanë të pamundur për të sjellë dhe për të plotësuar nevojat e inceneratorit, por kjo nuk është e mundur edhe për shkak të taksës së lartë që keni vendosur. Si do të zgjidhet kjo problematikë, sepse është e madhe dhe me aq sa di unë inceneratori i Elbasanit nuk është se funksionon ditë për ditë.

Është parashikuar në buxhet se rritja ekonomike për vitin 2022 do të jetë 4,1%, në një kohë që për vitin 2021 ishte parashikuar 7,6%. A mund të na thoni pse ndodh një rënie kaq e madhe? Qeveria do të marrë sërish borxh gjatë vitit 2022, 827 milionë euro, në një kohë që të ardhurat që parashikohen për të gjeneruar janë 804 milionë euro. Pra, ka vendosur të marrë borxh më të lartë se vlera e shtuar ekonomike e vitit 2022.

Sa u përket pensionistëve, parashikohet një fond prej 21 milionë eurosh, i cili mendoj se është vetëm për indeksimin e pensioneve sa i përket normës së inflacionit, si dhe janë parashikuar 28 milionë euro sa i përket bonusit të pensionistëve prej 5 mijë lekësh të rinj.

Gjithashtu, sa u përket shpenzimeve qeveritare është parashikuar të kemi shpenzime 51,2 milionë euro për rikonstruksionin e ndërtimeve, pajisje zyrash, blerje automjesh. A ju duket normale që të kemi një shpenzim të tillë, 51,2 milionë euro? Ndërkohë që ju vetë artikulonit në çdo moment, nga i pari, Kryeministri, deri tek i fundit i administratës, se keni problematika për shkak të pandemisë, paskeni edhe luksin për 51,2 milionë euro shpenzime qeveritare për mobilime, rikonstruksion zyrash, automjete, tavolina e të tjera.

Sa i përket krizës energjetike, me sa kam informacion, në mos gaboj, në muajin gusht qeveria i ka dhënë një kredi OSHEE-së rreth 40 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qeveria njez zyrtarisht borxhin që i ka dhënë OSHEE-së prej 167 milionë eurosh. Ministrja tha dhe shpjegoi se nuk do të ketë rritje të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, por e la të hapur dhe pa diskutim rritjen e çmimit të energjisë për biznesin e madh. A nuk do të ndikojë kjo te qytetarët? Mua më duket manovër e fshehur, sepse duke i rritur energjinë biznesit të madh, do të rriten çmimet dhe rritja e çmimeve do të bjerë mbi qytetarët.

Sa u përket ujësjellësve dhe kanalizimeve, a nuk duhet gjetur mënyra që të marrë fund njëherë e mirë ky lloj borxhi që ujësjellës kanalizimet kanë ndaj OSHEE-së? Vetëm Durrësi ka 52 milionë euro, ose 6,4 miliardë lekë detyrime ndaj OSHEE-së, pa folur për Vlorën, Patosin, Krujën e të tjera qytete.

Në total sa u përket investimeve publike, rezulton se janë më të ulta se viti 2021, përkatësisht 58 milionë euro më pak, pra -10% që do të jenë investimet publike për vitin 2022. Po i lexoj: menaxhimi infrastrukturës, kullimi dhe ujitja -16 milionë euro, ndërkohë viti 2021 ka pasur +16 milionë euro. A nuk mendoni se ka domosdoshmëri në të gjithë bujqësinë në të gjithë territorin e Shqipërisë? Për zhvillimin rural – 2,7 milionë euro, pra -9%, krahasuar me vitin 2021, transporti rrugor -74 milionë euro, -30%, arsimimi i mesëm profesional -1,8 milionë euro, ose -23%, zhvillimi i sportit dhe rinisë -0,9 milionë euro, -28%, shërbimi i kujdesit parësor -1,3 milionë euro, - 35%, shërbimi kujdesit dytësor -5,1 milionë euro, -21 %..

Klotilda Bushka – Zoti Sula, bëni pyetje, ju lutem, sepse këto mund të jepen gjatë diskutimit në parim.

Dashnor Sula – Ia thashë zotit zëvendësministër dhe specialistëve të Financave për të kuptuar sa e rëndësishme është. Pra, pse ka diferencë të vitit 2022 me vitin 2021?

Klotilda Bushka - Po, zoti zëvendësministër.

Besart Kadiu – Ajo që duhet theksuar është e dhëna kryesore, që është rritja ekonomike për vitin 2021, e cila është në vlerën 7,6%. Në raportet për vendet e Ballkanit Shqipëria në periudhën postpandemi rezulton ta ketë rritjen ekonomike më të lartën në rajon. Kjo e vendosur në perspektivën e rënies me 4% gjatë vitit të shkuar, gjatë vitit të pandemisë. Ajo që ju ngrini me të drejtë është se në vitin e ardhshëm rritja është 4%, por është më e lartë në trendin e dekadës së shkuar dhe është e ngjashme, por edhe më mirë se vendet e tjera të projektuar për vitet e ardhshme. Në këtë kuptim edhe buxheti ndërtohet mbi pritshmëritë që kemi për rritjen ekonomike.

Sa i përket shqetësimit tuaj për mjedisin, patjetër që mjedisi mbetet prioritet i vullneti politik. Kjo është bërë e qartë dhe inceneratorët kanë qenë një zgjidhje për këtë çështje. Ajo që ju zoti Sula thoni me të drejtë është që për t'u kujdesur për mjedisin ka kosto për

transportin, menaxhimin, selektimin dhe asgjësimin final. Kështu që në këtë këndvështrim ju po e ngrini si shqetësim, por praktikisht po mbështetni në njëfarë mënyre nevojën për financime ende më shumë për mjedisin, inceneratorët ose çdolloj mënyre tjetër që njeh bota për mjedisin. Në këtë këndvështrim shqetësimi do të adresohet, do të shihet mënyra më e mirë për ta bërë efikase koston që ju përmendët me shqetësim.

Sa u përket investimeve publike, që janë në rënie, patjetër rindërtimi ka zënë një pjesë të madhe të shpenzimeve për këtë vit, por me mbylljen e rindërtimit të shumicës së projekteve viti i ardhshëm është me rënie në shpenzime.

Sa u përket pyetjeve të tjera, përgjigjet do t'ju japë zonja Dhëmbi.

Klotilda Bushka - Po zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Sa i përket pyetjes së parë, që lidhet me inceneratorin e Elbasanit, në fakt, problemet janë shumë teknike, si, për shembull, kapaciteti e të tjera. Ne merremi kryesisht me zbatimin e kontratave, që janë në fuqi për inceneratorët, por dua t'ju them se ne mendojmë për një zgjidhje të përgjithshme, për mbetjet urbane, për menaxhimin e tyre dhe për kostot e tjera që vijnë nga ndryshimi i standardit të trajtimit të plehrave, pra që nuk trajtohen më me landfille të paligjshme, por me landfille të certifikuara dhe me inceneratorë. Pikërisht, për këtë është ngarkuar Ministria e Mjedisit të bëjë një metodologji, një studim se ku do të derdhen plehrat në Shqipëri, pra cilat do të jenë pikat e certifikuara për mbetjet. Po të shikoni nenin 15, aty do të shikoni zgjidhjen që ne kemi menduar. Kemi vendosur një shumë prej 500 milionë lekësh dhe kemi shpjeguar se ato para do të shpërndahen në bashki në përputhje me studimin dhe metodologjinë që do të rrjedhë nga studimi që do të bëjë Ministria e Mjedisit. Pra, kjo është e reja e këtij viti.

Së dyti, zëvendësministri ju shpjegoi, pra nuk mund të merret shifra nga 7,6 në 4,1. Keni parasysh se 7,6 e këtij viti vjen mbi bazën e -4-ës së vitit të kaluar. Pra, 7,6-a është shumë e thjeshtë mbi nja bazë që vjen nga një rënie, një recension -4% në vitin 2020. Tani ngadalësohet ritmi i rritjes, pasi vjen mbi një bazë më të lartë.

Në lidhje me financimin e deficitit, dua t'ju shpjegoj se kjo është rrjedhojë, pra sa do të jetë Eurobondi, sa do të jetë financimi në instrumente të tjera, pasi duhet të shikoni se deri në vitin 2021 borxhi ka ardhur në rritje. Vitin tjetër do të fillojë të zbatohet rregulli fiskal, kështu që borxhi vjen duke rënë në raport me GDP-në. Kjo është e detyrueshme dhe nuk mund ta ndryshojë askush pa ndryshuar ligjin organik të buxhetit. Në vitin 2024 do të kemi një rregull primar që është një tregues shumë i rëndësishëm është një nga rregullat fiskale që ne nuk mund t'i shmangemi. Duke zbatuar këto dy rregulla fiskale, ne kemi arritur në

konkluzionin se deficitin që kemi parashikuar këtë vit, është brenda këtij rregulli të madh që ne kemi vendosur në ligjin organik të buxhetit.

Gjëja e parë që vihet në dukje është se deficitin është më i vogël se shpenzimet kapitale. Pra, deficitin e vitit të ardhshëm shkon për të financuar vetëm investime, jo për paga, pensione e të tjera. Kjo e bën të shëndetshëm.

Në lidhje me pensionistët, mund të themi se ne kemi zbatuar atë që është shkruar në programin e qeverisë. Ka dy elemente thelbësore: indeksimi do të jetë i përhershëm, njëkohësisht i përhershëm do të jetë edhe bonusi i pensionistëve, që deri tani ka qenë fakultativ në përputhje me rezultatet e zbatimit të buxhetit, pra “na del, nuk na del fondi në fund të vitit”. Këtë e tutje 3,5 miliardë lekë janë të buxhetuar brenda këtij skenari, që ne ju kemi paraqitur. Nëse mbledh indeksimin plus bonusin, të dyja bashkë bëjnë një rritje mesatarisht 5% për pensionet çdo vit.

Shpenzimet që ju i quani shpenzime luksi administrative të disa institucioneve buxhetore, që lidhen me pajisje automjete dhe rikonstrukcion zyresh unë do të them se kjo pyetje na u drejtua e dhe në Komisionin e Ekonomisë dhe ne përgatitëm të gjitha tabelat mund t’juja vëmë në dispozicion edhe juve, pra cili institucion. Ne i pamë me kujdes, me qëllim që të kishim një përgjigje edhe për Komisionin e Ekonomisë. Po të shikoni, për shembull, automjetet ishin 140 milionë lekë, dhe ishin të përqendruar 36 milionë makinat e burgut dhe ambulancat. Pra, janë automjete funksionale, jo zyresh, për Prokurorinë e Përgjithshme, Gardën, për disa inspektorate. Pra 36-milionëshi ishte shuma më e madhe, të tjerat ishin minimaliste.

Dashnor Sula – Edhe Kryeministria ka marrë.

Mimoza Dhëmbi – Kryeministria jo, por rikonstrukcione po.

E keni edhe listën e rikonstrukcioneve. Pra, për ato institucione që ofrojnë shërbime për publikun. Pra, edhe kompjuterët, edhe pajisjet e zyrave. Po t’i shikoni, për shembull, janë tatimet 200 milionë blerje kompjuterësh, janë laboratorë në Ministri të Arsimit, pra janë gjëra shumë funksionale. Gjërat e zyrave janë minimaliste, ju garantoj për këtë, sepse i mbajmë sytë hapur vetë, ne e bëjmë censurën.

Sa i përket krizës energjetike, ministrja e shpjegoi se që në aktin normativ të këtij viti kemi parashikuar 10 miliardë lekë si garanci sovranë për të mbështetur krizën energjetike, pikërisht për të mos lejuar që të rritet çmimi, siç është deklaruar politikisht publikisht për qytetarët dhe bizneset e vogla. Kjo nuk do të thotë automatikisht rritje për bizneset e mëdha, ku ka disa rregullime të tjera, e blejnë në tregun e lirë, që unë nuk di t’i shpjegoj teknikisht, të them të drejtën, por që rëndësi ka që mbrohet konsumatori i vogël, mbrohet biznesi i vogël

dhe qytetarët, përveç asaj që rritet ndihma ekonomike, indeksohen pensionet, që janë skema që përputhen me njëra-tjetrën për të përballuar krizën energjetike. Në vitin e ardhshëm ka 8 miliardë lekë, po ta shikoni në tabelën e buxhetit, të parashikuara si kredi nëpërmjet buxhetit për sistemin energjetik për të blerë energji. Pra, këto janë dy elementet për të përballuar krizën.

Ujësjiellësit po ashtu janë shqetësimi ynë, për të cilët ne ia pastrojmë llogaritë, por ato i mbushin dhe nuk paguajnë OSHEE-në kryesisht, sepse shtet me shtet është historia që sa kohë ne bëjmë përpjekje për t'i netuar detyrimet ato vazhdojnë me to. Nuk është zgjidhje për krizën energjetike, duke i marrë përsipër buxheti i shtetit detyrimet e tyre. Ka një grup, një komitet që merret me detyrimet e ndërsjella të të gjitha ndërmarrjeve të sistemit energjetik, por përfshin edhe detyrimet që ka buxheti i shtetit ose institucionet e tjera, me qëllim që të bëhet një skemë e plotë e shlyerjes, ose, nëse ujësjiellësit nuk do të menaxhohen kështu, do të gjendet një mënyrë tjetër për t'i marrë nën administrim dhe për t'i bërë likuide.

Investimet i shpjegoi zëvendësministri.

Keni parasysh se nuk mund të krahasohet viti 2021 me vitin 2022 dhe të themi që në shumë absolute ka ulje. Viti 2021 është viti që ka pasur dy elemente: rindërtimin, në masën më të madhe të alokimit dhe përdorimit të fondeve, si dhe stimulin që iu bë ekonomisë për të ruajtur këtë rritje ekonomike që ne e pamë, na rezultoi këtë vit, pra stimulin që i dhamë nëpërmjet investimeve në infrastrukturë e të tjerë. Por nuk është se ka rënie të dukshme. Investimet vazhdojnë të mbeten 6,4% e GDP-së, ndërkohë që ne e kemi deklaruar në afatgjatë 5% është maksimumi që mund të jenë investimet publike, pra pasi të mbarojmë krizat që kemi nëpër këmbë. Kështu që është i lartë niveli 6,4% e PBB-së është nivel i rëndësishëm.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Ju falënderoj për skrupolozitetin tuaj. E dimë shumë mirë, kemi 4 vjet dhe ky është viti i 5-të që e keni vërtetuar se jeni shumë të kujdesshëm në disa shpenzime dhe unë do të doja t'ju falënderoja ju si staf për këtë.

Tani radhën për pyetje e ka zoti Kollçaku.

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit!

Më vjen mirë që në sferën e mbrojtjes shpenzimet janë në linjë me angazhimet që kemi marrë në samitin e Uellsit për të arritur në vitin 2014 2%, pra 1,47, në vitin e ardhshëm 1,75, në vitin 2023 1,85. Megjithatë, unë bashkohem me shqetësimin e disa kolegëve deputetë që buxheti i mbrojtjes duhet të zhvishet nga disa detyrime që nuk janë të mbrojtjes, janë disa struktura që janë të atashuara në Ministrinë e Mbrojtjes, si: regjimenti i

helikopterëve, shëndetësisë, të Ministrisë së Brendshme, emergjencat civile që janë të atashuara në Ministrinë e Mbrojtjes. Bashkitë dhe strukturat e tjera duhet të kontribuojnë në buxhet, po ashtu edhe strukturat e tjera.

Unë mendoj se në të ardhmen ne duhet të shohim strukturat që buxheti i mbrojtjes të jetë vërtet buxhet mbrojtjeje. Më vjen mirë që parashikohet rritje e rrogës së ushtarakëve, një rritje që duhet të kishte ndodhur që më parë, por nuk ndodhi për shkak të pandemisë dhe të tërmetit, edhe pse kjo strukturë ka qenë në ballë të dy emergjencave. Në NATO ka një konsensus të përbashkët që kriza e pandemisë të mos kthehet në krizë sigurie. Jam i lumtur të shoh që ka një vëmendje të qeverisë sa i takon buxhetit të mbrojtjes.

Meqë jemi në këtë pikë kam një pyetje direkt. Ditët apo javët që do të vijnë do të fillojnë punimet nga Aleanca në Aeroportin e Kuçovës, një investim mbi 50 milionë euro, si dhe janë parashikuar disa angazhime dhe detyrime të qeverisë shqiptare dhe të Ministrisë së Mbrojtjes sa u takon shpronësimeve, për rrethim dhe për infrastrukturën ndihmëse. Dua të di: a është parashikuar në buxhetin e vitit 2022 zëri për këtë qëllim? Si do të realizohet shpronësimi i fermerëve apo i familjarëve që do t'u shpronësohet toka?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zoti Zëvendësministër, fjala për ju, për t'u kthyer përgjigje pyetjeve.

Besart Kadiu – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke qenë se është një pyetje shumë specifike dhe teknike, do t'ia jepja fjalën zonjës Mimoza Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Duke u përqendruar te komentet mbi buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes dua t'ju vë në dukje, se të gjitha ato që u thanë janë të vërteta, pasi të pranishëm janë edhe përfaqësues të Spitalit Ushtarak dhe të emergjencave civile. Po ta shohësh në tërësi rritjen e buxhetit të mbrojtjes, i cili në krahasim me atë të vitit 2021 është rreth 8 miliardë lekë, 5 miliardë lekë janë të destinuara për shpenzimet kapitale, pra asete që mbeten. Nga 5 miliardë shpenzime kapitale, 3,5 miliardë janë për forcat e luftimit, pra pjesën më të madhe të rritjes e ka marrë ushtria reale, kjo është e vërteta. Po të shohësh mbështetjen sociale për ushtarakët ose për Spitalin Ushtarak e të tjera, ka një rritje ose minimaliste ose zero.

Në lidhje me Aeroportin e Kuçovës dua t'ju them se nuk i njohim detajet dhe shumë prej çështjeve janë konfidenciale, por nëse është detyrim i partnerëve, të jeni të sigurt që me rritjen që ju përmenda prej 8 miliardë lekësh, ata janë përfshirë ose do të përfshihen patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Fjalën për pyetje e ka zoti Korreshi.

Më pas fjalën e ka zonja Bardeli dhe zonja Felaj.

Jeni edhe ju zonja Hoti?

Pra, janë edhe 4 kolegë për pyetje dhe më pas do të kalojmë në diskutime.

Në fund kam edhe unë 2 pyetje, nëse nuk do t'i ezaurojnë kolegët.

Saimir Korreshi – Faleminderit!

Në lidhje me bujqësinë, ju thoni që për sivjet ose për vitin 2022 keni parashikuar 26 milionë euro, ndërkohë që në programin qeverisës, të cilin e miratuat para 1 muaji, thuhej se për bujqësinë kishte një plan të madh se do të bënit 1-in dhe pararojën, flitej për 70 milionë euro. Dua të di nëse shifra prej 70 milionë eurosh ishte për 4-vjeçarin dhe çfarë ka ndryshuar? Nëse ky 70 milionë euro është për 4 vjet, atëherë jemi në rregull, pararojë do të dalim. Po 26 milionë? Këto 26 milionë euro nuk dalin për t'i arnuar plasmasët e jo më për t'i ndërruar. Sa ka qenë buxheti për vitin e kaluar ose sa ka qenë shuma e alokuar për fermerët dhe bujqësinë?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Korreshi!

Kush do ta marrë nga të ftuarit fjalën për t'u përgjigjur? Zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Në lidhje me këtë element specifik vetëm për subvencionet e fermerëve mund t'ju deklaroj se janë rreth 1,2 miliardë lekë më tepër, fondi normal ka qenë 1,6 është rreth 2,8 besoj, nuk mund t'jua them fiks me saktësi, por ka një rritje prej 1,2 miliardë lekësh për mbështetjen e bujqësisë. Nëse do të jetë 70 milionë, më duhet t'ju them se angazhimet e marra në programin e qeverisë janë për 4 vjet, është 70 pjesëtim për 4, por janë angazhime, edhe sikur të jetë 70 në vit, në këto momente nuk mund t'jua them (më vjen keq t'ju them se do të jetë 70 çdo vit), por mund të shkojmë tek 70-milionëshi vitin e katërt. Do të shkojmë gradualisht, sepse për 1 vit nuk mund të shtojmë menjëherë 50 milionë euro për një zë të vetëm, pra duhet të jemi edhe realist.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E rëndësishme është që e kemi shtuar mbi 10 milionë euro në krahasim, po flas vetëm për një zë të bujqësisë, pra subvencionin e fermerëve. Duhet të kini parasysh që është program i IPARD-it, i cili është komplementar me programin e subvencionit...

Saimir Korreshi – Nuk ka nevojë për politikë, sepse atë e di unë, ju pyeta...

Mimoza Dhëmbi – Të dy bashkë mund të shkojnë edhe 70 në vit.

Saimir Korreshi – Nuk ishte ashtu te programi i qeverisë.

Klotilda Bushka – Kjo ishte përgjigja e zonjës Dhëmbi.

Faleminderit!

Zonja Bardeli, fjala për ju.

Greta Bardeli – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirë se erdhët, zoti Zëvendësministër!

Ka mbi 10 mijë ish-të përndjekur politikë që kanë marrë vetëm një kësht, janë mbi 1 mijë dosje që kanë ngelur pezull në Ministrinë e Drejtësisë dhe mendoj se ka një zvarritje të qëllimshme nga administrata e këtyre institucioneve, duke i sorollatur pa fund njerëzit për plotësimin e dokumenteve, ndërkohë që dosjet e tyre janë plotësuar sipas ligjit.

Pyetja ime është: pse zvarritet pafundësisht dëmshpërblimi i kësaj shtrese, pra i të përndjekurve politikë, apo nuk është ky prioriteti i kësaj qeverie? Kur do të konkludohet dëmshpërblimi i tyre? A ka ndonjë afat të përcaktuar?

Ministria pak më parë tha që do të shihet vit pas viti, ju lutem, ju kërkoj që ta përmbyllni sa më shpejt!

Pyetja tjetër konsiston në çështjen që mua më prek direkt jo vetëm si banore, por edhe si përfaqësuese e qytetit të Shkodrës në këtë komision. Në të gjitha raportet ndërkombëtare dhe vendase rajoni i Shkodrës theksohet se është ndër rajonet më të varfra në Veri të Shqipërisë dhe ka një mungesë të theksuar të investimeve ndër vite të kësaj qeverie. Cilat janë arsyet? Ndërkohë shohim që investohet, dërgohet atje ku Kryeministri apo ndonjë ministër ka preferencat e tij...

Klotilda Bushka – Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave janë të pranishëm janë për buxhetin, prandaj, ju lutem, fokusoheni aty...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Greta Bardeli - ...dhe paraqitet një strategji dhe informacion i detajuar ku këto investime mungojnë në mënyrë të theksuar. Pyetja tjetër që kam, në fakt, dua të di nga ju në lidhje me kontratat e partneritetit publik-privat, mbi çfarë analize përgatitet në raportin kombëtar të investimeve, të situatës së varfërisë dhe mungesës së kohezionit social? Ku na çon ky borxh, i cili është një borxh mbi kufirin 85%, ndërkohë që vazhdojnë të lidhen këto lloj kontratash ndërmjet partnerit publik dhe privat, vazhdojnë të ngrihen agjenci, mbivendosje institucionesh, të cilat patjetër që do të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese dhe në SPAK? Edhe për sa kohë shqiptarët duhet të vazhdojnë të paguajnë të njëjtën gjë?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, zonja Dhëmbi.

Mimoza Dhëmbi – Në lidhje me kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, në fakt, u përgjigj edhe zonja ministre, në këtë buxhet janë 1 miliard lekë, ashtu sikurse ishte edhe për

vitet 2020 dhe 2021. Kjo lidhet me hapësirat që lejon buxheti në kushtet e dy fatkeqësive që kemi pasur, por në të ardhmen mund të rishihet ritmi i kësaj pagese. Dua t'ju theksoj vetëm një gjë, për të gjithë të gjallët janë paguar të gjitha këstet dhe tani bëhet fjalë vetëm për trashëgimtarët, të cilët kanë marrë këstin e tretë dhe vitin tjetër fillon i katërti.

Sa i takon zgjatjes së dokumentacionit më duhet t'ju them se ne nuk kemi dijeni se çfarë ndodh në Ministrinë e Drejtësisë, por di që ka pasur afate kohore dhe aplikimet janë mbyllur, sepse nuk janë pa fund, ndoshta mund të jetë si rezultat i ndonjë stoku të krijuar më parë.

Klotilda Bushka – Zonja Dhëmbi, ju përgjigjeni sa i takon projektligjit dhe buxhetit dhe nuk jeni këtu në rolin e përfaqësuesit politik të qeverisë për të kthyer përgjigje për çdo proces. Ju lutem, fokusoheni tek ato pyetje që janë kompetencë e ministrisë suaj dhe të çështjes së projektbuxhetit!

Mimoza Dhëmbi – Keni të drejtë.

Besart Kadiu – Faleminderit!

Me aq sa unë di, janë përmendur të gjitha buxhetet sa u takon ish-të përndjekurve për çdo vit.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zëvendësministër!

Zonja Dhëmbi, vazhdojmë me përgjigjet.

Mimoza Dhëmbi – Në lidhje me pyetjen që qyteti i Shkodrës nuk ka investime, mund t'ju vë në dispozicion listën dhe ta shihni, por më duhet t'ju them që nuk ka investime të fokusuara direkt për Shkodrën, por ka investime të tërthorta që e prekin edhe qytetin e Shkodrës.

E kam dëgjuar edhe në Komisionin e Ekonomisë faktin që qyteti i Shkodrës nuk ka asnjë investim dhe për këtë kam kërkuar që këtë gjë të ma nxjerrin veçmas dhe do t'ju vë në dispozicion.

Në lidhje me PPP-të, aktualisht janë 13 kontrata dhe nuk ka asnjë kontratë të re për vitin 2022, kështu që nuk ka nevojë për analiza, për thellim të borxheve e gjëra të tjera.

Të 13 kontratave që janë në fuqi ne u shërbejmë me pagesa dhe pagesat për vitin 2022 janë më pak se në vitin 2021, sepse disa projekte mbyllen dhe disa e ulin ritmin e tyre. Ky element është pozitiv.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Fjalën e ka zonja Hoti.

Elda Hoti – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar, dua t'ju pyes se çfarë keni parashikuar për qarkun e Lezhës? E shtroj këtë pyetje, duke pasur parasysh që varfëria në këtë qark është në nivele relativisht të larta. Sipas të dhënave të INSTAT-it, Lezha ka shënuar rritjen më të lartë të papunësisë, me 22,7%. Ndihamat ekonomike që marrin qytetarët janë qesharake dhe nuk mbulojnë as minimumin jetik dhe investimet në këtë qark janë pothuajse inekzistente.

Klotilda Bushka – Zonja Hoti, ju lutem, bëni pyetjet!

Elda Hoti – Pjesë e programit të “100 fshatrave” të Rilindjes suaj urbane për të investuar dhe për t'i kthyer në zona atraktive dhe turistike në qarkun Lezhë janë Skuraj, Katund i Vjetër, Orosh, Ishull Lezhë dhe Fishtë, por deri tani nuk është bërë asnjë investim, ka mungesë investimesh në infrastrukturë, energji, kanalizime, ujësjellës e me radhë, si dhe asnjë mbështetje për bizneset që operojnë në këto zona. Dua të di: a keni ju ndonjë plan apo një datë të caktuar se kur mund të fillojnë?

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Hoti!

A t'i bëj edhe unë pyetjet dhe të përgjigjeni një herë e mirë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam dakord me kolegët e opozitës që në fillim të kthehet përgjigje.

Zonja Dhëmbi, fjala për ju.

Mimoza Dhëmbi – Në lidhje me investimet e qarkut Lezhë në këto momente nuk mund t'ju jap listën, por do t'ju vë në dispozicion radhës tjetër, nga lista e madhe të investime.

Dua t'ju them vetëm këtë që qarku i Lezhës vlerësohet prej jush si zonë e varfër, mirëpo ne kemi politikën e re, siç e përmendi edhe ministrja, për ndihmën ekonomike, ju e përmendët veçmas që është minimaliste, por ne e kemi rritur totalin e fondit për të gjitha familjet 10%, ndërkohë kemi diferencuar familjet me 3 fëmijë, jetimët dhe gratë e dhunuara, të cilët do të marrin 2-3-fishin e ndihmës ekonomike. Të paktën kjo është një politikë që do ta zbusë sadopak këtë dukuri dhe do të jetë mbarëkombëtare, në të gjitha zonat dhe qarqet, meqë ju e përmendët ndihmën specifike, ndërkohë që ka edhe programe të tjera për nxitjen e biznesit e të tjera, të cilat mund ta gjallërojnë dhe të rrisin mirëqenien dhe të ardhurat e familjeve.

Sa i takon programit të “100 fshatrave” është një program që e mbulon Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ne kemi alokuar 500 milionë lekë për vitin 2022, por se për kë fshat do të bëhet studimi i parë dhe i dytë këtë nuk mund t'ju them, por ky program vazhdon.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Kam disa pyetje, edhe pse një pjesë të pyetjeve m'i ezauruan kolegët. Pyetja e parë ka të bëjë me çështjen e buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Kryesisht shoh që ka një rritje për vitin 2022, por dua të kuptoj, a është harxhuar fondi i ndihmës gjatë vitit 2021 dhe si ndodh me vitin 2022? Sa është fondi për ndihmën juridike falas?

Me shumë kënaqësi shoh që keni menduar të jepni buxhet për drejtësinë për të miturit, e cila është një nga pjesët e reformës në drejtësi. Pyetja e dytë që kam është: a keni në program ndërtimin e ndonjë instituti riedukimi për të miturit apo vetëm investime në institucionet ekzistuese?

Pyetja e tretë ka të bëjë me grantin e bashkive. Sa është rritja që u jepet bashkive me buxhetin e vitit 2022? Kjo rritje vjen ngaqë bashkitë kanë performuar mirë apo janë përmirësuar treguesit financiarë të buxhetit të shtetit?

Pyetja e katërt ka të bëjë me investimet në infrastrukturën rrugore. Cilat janë veprat kryesore që do të financohen në vitin 2022? A përfshihet Unaza e jashtme e Tiranës në këto?

Pyetja e fundit. Ka një rritje të konsiderueshme të buxhetit për reformën në drejtësi, e tillë është rritja çdo vit, madje këtë vit është edhe më konkrete, sepse tashmë rritet mbështetja edhe në kuadër të strategjive të luftës antikorrupsion. Institucionet e drejtësisë, në konsultimet që kanë bërë me Ministrinë e Financave, a kanë sjellë kërkesa pasi është miratuar nga qeveria projektbuxheti?

Në komision kemi kërkesa para projektbuxhetit, por pas kësaj periudhe nuk kanë ardhur më. Këtë informacion duhet ta dimë, sepse do të vijojmë me dëgjesa në kuadër të konsultimit të buxhetit, pra për të pasur një ide më të qartë dhe për t'u përgatitur për këto diskutime.

Faleminderit!

Mimoza Dhëmbi – Është e vërtetë që ndihma juridike në Ministrinë e Drejtësisë ka më shumë fonde të alokuara sesa në vitin 2021, 84 milionë nga 75 milionë, pra rreth 9 milionë më shumë, sepse institucion i vogël është, duke pasur parasysh edhe totalin, është mbi 10% i rritur. Objektivi ka qenë përmirësimi i këtij shërbimi, por kam idenë se Ministria e Drejtësisë raporton për të gjitha programet e veta, kështu që nuk po futem në detaje, sepse ata i dinë më mirë.

Edhe sa i takon institucionit të të miturve, mendoj se Ministria e Drejtësisë mund t'ju japë përgjigje shteruese kur të bëhen seancat e dëgjimit, ashtu sikurse edhe për institucionet e drejtësisë, ne jemi të pranishëm këtu, kërkesa ka pa fund, por e mira nuk ka fund. Pas paraqitjes në qeveri ne nuk kemi më komente nga ata, nuk e di sa të kënaqur do të jenë, por

ne kemi prioritarizuar në maksimum fondet për këto institucione, megjithatë ata do të vijnë vetë t'i thonë, sepse e di që ka pakënaqësi dhe ca gjëra, sepse ndonjëherë nuk ua kemi zgjidhur komentet sa u takon strukturave të tyre të pagave.

Në fushën e infrastrukturës më duhet t'ju them se Unaza e Tiranës vijon, nuk mund t'ju them e jashtme apo e brendshme, por 3 lote të reja janë hapur që me aktin normativ të qershorit dhe do të vazhdojnë të financohen intensivisht edhe vitet e ardhshme me qëllim që të përfundojë sa më shpejt kjo histori që ka shumë vite që stërzgjetet. Po ashtu, edhe tuneli i Llogorasë është një ndër projektet madhore, i cili ia vlen të përmendet.

Sa u takon granteve të bashkive, mendoj se drejtori i Financave Vendore mund t'jua shpjegoj.

Klotilda Bushka – Po, zoti Fran.

Fran Brahimi – Në përgjithësi buxheti i pushtetit vendor është rritur me 3,3% krahasuar me vitin 2021, por nuk duhet të harrojmë që përveç këtij buxheti, që i është dedikuar vetëm bashkive, janë edhe rreth 1,3 miliardë lekë që janë të destinuara për të shkuar në bashki për funksionet e saj. Janë 600 milionë në Ministrinë e Mbrojtjes, për emergjencat e mbrojtjes civile, 700 milionë në Ministrinë e Turizmi, të cilat janë për mjetet urbane, pra të dyja bashkë bëjnë 1,2 miliardë lekë që u shtohet ose duke e krahasuar me vitin 2021 rritja do të jetë 5,1%.

Transferata e pakushtëzuar e dedikuar për t'iu shpërndarë vetëm bashkive vijon nga 2 deri në 4%, pra është 3% mesatarisht për bashki. Bashkitë, sipas formulës që kanë treguesit e tyre, i përfitojnë të gjitha dhe kanë minimalisht 2 deri në 4%.

Rritja e buxhetit në total për qeverisjen vendore ka ardhur si rezultat i dy faktorëve, nga përmirësimi i treguesve makro-ekonomik të buxhetit të shtetit që ka kontribuar më shumë, por edhe si rritje e performancës së vlerës të të ardhurave ku vetë bashkitë kanë parashikuar rreth 1,5 miliardë të ardhura për vitin 2022 më shumë sesa kanë mbledhur në vitin 2021. Këta janë faktorë të ndërthurur.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Falënderoj të ftuarit për përgjigjen që u dhanë pyetjeve, zonjën Dhëmbi, zotin Fran dhe zëvendësministrin Kadiu!

Është shumë e rëndësishme që të marrin përgjigjen e pyetjeve tona nga ju për të vijuar me këtë proces. Me zonjën Dhëmbi dhe zotin Fran kemi vite që punojmë, ju jeni ekspertët më të mirë dhe nuk mund ta mendoj se si mund të diskutohet buxheti pa prezencën tuaj, prandaj ju falënderoj për të gjithë kontributin tuaj në vijim!

Ju do të vazhdoni të rrini, pasi do të kalojmë në diskutimin në parim dhe më pas në votimin në parim.

I ftoj kolegët deputetë për diskutime në parim.

Kush e do fjalën?

Po, zonja Tyli.

Më pas fjalën e kanë zonja Felaj, zoti Sula dhe zoti Bllako.

Dhurata Tyli – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave!

Së pari, dua të bëj një saktësim, duke qenë se e pranishme është zonja Dhëmbi, pasi ministrja iku, por në fakt e deklaroi, kështu që ju bie barra juve ta saktësoni. Bëra një pyetje për 900 milionë lekë të akorduara. Unë thashë për bashkinë e Tiranës, sepse e pashë në buxhet që ishte për bashkinë e Tiranës, ndërsa ministrja tha që është për Ministrinë e Kulturës. Në fakt, në buxhet është 900 milionë lekë, janë për ndërtimin e Teatrit në bashkinë e Tiranës, ku përfitues është bashkia Tiranë.

Unë mendoj që ministrja duhet të ishte korrekte në atë që tha, sepse unë nuk pyeta kot, por për të deklaruar që 900 milionë lekë janë për ndërtimin e teatrit, për Bashkinë e Tiranës, ku ndërkohë ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese që i ka rrëzuar të gjitha aktet normative të dala për këtë qëllim.

Ky saktësim duhej bërë nga unë, meqenëse ministrja e mohoi këtë gjë, që në fakt nuk është serioze. Nuk po e zgjas më me pyetjet e tjera.

Ajo çfarë u deklarua këtu, edhe nga pyetjet e kolegëve deputetë, është një buxhet i dy ekstremeve, buxheti i njërit ekstrem të luksit, 20 miliardë lekë për zyra e mobilie, makina dhe shtesë të stafit të Kryeministrit, që unë nuk di pse i duhen Kryeministrit shtesa stafi, kur ky staf është rritur gjatë këtyre 8 vjetëve në mënyrë ekstreme dhe, nga ana tjetër, është varfëria ekstreme. Thashë varfëria ekstreme, sepse pyeta për minimumin jetik, dhe nuk ka asnjë lloj tendence të qeverisë për t'iu afruar minimumit jetik. Minimumi jetik është i ligjruar në një studim të Avokatit të Popullit, që është botuar si studim, që nuk është një organizatë joqeveritare, dhe është e pafalshme që ministrja e Financave nuk njeh raportin e Avokatit të Popullit, përkundrazi, unë prita që ajo të thoshte: “E njohim dhe do ta miratojmë me një vendim qeverie minimumin jetik”. Diferenca mes ndihmës ekonomike dhe minimumit jetik duket se me buxhetin tuaj do të duhet një shekull të afrohet. Ndaj them që është buxheti i dy ekstremeve: i luksit e i koncesioneve dhe i varfërisë ekstreme.

Në raportin e fundit të Eurostat-it vendi i vetëm në Europë me 51% të popullsisë shqiptare është drejt varfërisë ekstreme.

E thashë dhe e përsëris, ta marrin vesh qytetarët që kemi 20 miliardë lekë për makina dhe luks dhe 1 miliard lekë për ish- të përndjekurit politikë. Kemi 20 miliardë lekë për

makina dhe luks, si dhe kemi 1,6 miliardë lekë të paktën nga çfarë u deklarua për vitin 2021 për ish-pronarët. Ish-pronarëve, që nga viti 2013, nuk u është dhënë sikur 1 metër katror kompensimin financiar, por po u shtoni edhe një shekull tjetër për t'ua dhënë.

Ndërkohë, unë mund të flas pa fund për qeverisjen vendore, por unë po them vetëm atë që më thanë specialistët lidhur me shifrat. Nëse ky vit, 2021, ishte 1,1 % e buxhetit për qeverisjen vendore, transfertat e pakushtëzuara, këtë vit që vjen parashikohet 1%, pra e keni të ulur nga viti 2021, ndërsa funksionet e deleguara, janë një qeshje tjetër e juaja me bashkitë, sepse ju u kaloni para vetëm për punonjësit. Edhe grandet që u kaloni janë kryesisht grande për fushata elektorale dhe grande për qendrat e qytetit, që, përpos të gjithave, po varfëroni edhe më tej zonat rurale, që janë pa asnjë investim dhe gjithë qytetarët vijnë pinë një kafe aty në qendër të qytetit, konsumojnë edhe ato para që kanë dhe asnjë të mirë nuk ka sjellë as pjesa e investimeve të huaja.

Ndaj, qeverisjen vendore e keni ulur në 1%. Mos bëni krahasim me vitin 2013, se, nëse ka regres dhe kthim pas nga ju, është sigurisht qeverisja vendore. Pas vitit 2013 ju e keni konsideruar qeverisjen vendore si një drejtori rajonale të qeverisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çupi!

Zonja Felaj, fjala për ju.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Nga të gjitha ato që u prezantuan gjatë mbledhjes së sotme është e qartë që kemi të bëjmë me një buxhet, i cili duket ambicioz dhe unë uroj dhe shpresoj që edhe përpjekjet për ta realizuar atë buxhet të jenë të tilla.

Me këtë buxhet synohet të sigurohet vazhdimësia e rimëkëmbjes ekonomike dhe është e qartë që ne akoma nuk kemi mbyllur procesin e rindërtimit dhe as procesin e vaksinimit për të gjithë popullsinë apo për të gjithë target moshat e përfshira për vaksinim, kështu që është një gjë shumë e mirë, që vijimi i të dyja këtyre sfidave të mëdha gjen mbështetje në buxhetin e vitit 2022.

Po kështu, u ndjeva mirë që ka një mbështetje për kategori të caktuara punonjësish, sikundër përmendëm që ata do të trajtohen me një pagë të shtuar. Dua të kujtoj që nuk është hera e parë që ne rrisim pagat e mësuesve, rritim pagat e sektorit të sigurisë apo të mbrojtjes apo atyre të burgjeve, sepse edhe vitin e kaluar, edhe më parë ka ndodhur kjo gjë dhe është shumë mirë që ata përfitojnë një mbështetje.

Po kaq mirë më vjen dhe besoj se biem të gjithë dakord që ka pasur një vëmendje në drejtim të rritjes së mbështetjes buxhetore për të gjitha kategoritë më të dobëta dhe ju keni ndarë familjet që kanë një numër më të madh fëmijësh dhe nënat e vetme.

Në fakt, para se unë të largohesha i kisha kërkuar fjalën kryetares dhe nuk e di nëse mund ta marr tani një përgjigje, sepse doja të bëja një pyetje dhe këtu besoj se do të më bashkoheshin të gjitha zonjat deputete të këtij komisioni, lidhur me detyrimin që kanë të gjitha institucionet qendrore përfshirë edhe Ministrinë e Financave për reflektimin e perspektivës gjinore në këtë buxhet. Nuk e di nëse jeni ju personi që mund ta marr realisht këtë përgjigje, por besoj se Kuvend do e kishte të nevojshme edhe për shkak të angazhimeve që ka marrë qoftë në kuadër të miratimit të rezolutës së OKB-së nr. 9025 “Për sigurinë për gruan” dhe strategjisë për barazinë gjinore që është miratuar në qershor të këtij viti që të dinte se si është mbështetja buxhetore apo si reflektohet perspektiva gjinore në buxhetin e vitit 2022 në total.

Ndërkohë, gjëja tjetër që vlerësoj është se ka një fokus po ashtu të veçantë dhe një mbështetje të mirë buxhetore edhe në drejtim të mbështetjes së shërbimeve dixhitale. Sigurisht që gjithë këto vite ka pasur një rritje të numrit të shërbimeve dixhitale, së fundi është dixhitalizuar sistemi i ankesave që lidhen me prokurimet publike dhe është shpallur edhe dixhitalizimi i shërbimeve që ofron kadastra.

Pyetja ime është: si është parashikuar që të ndahet kjo mbështetje buxhetore dhe në cilat drejtime do të orientohet kryesisht?

Investimet për pjesën infrastrukturore po ashtu gëzojnë mbështetje dhe ky është një lajm i mirë për të gjithë ata që presin që rrugë të rëndësishme në akse të rëndësishme kombëtare dhe jo vetëm të mund të përfundohen. Kështu që, unë rikthehem te fjala ime e fillimit që ne do të duhet të jemi të kujdesshëm në radhë të parë si Komision i Ligjeve për të kuptuar që buxheti realizohet nga ana e institucioneve që vijnë dhe përgjigjen në këtë komision, por të njëjtin detyrim duhet ta kenë edhe komisionet e tjera, me qëllim që çfarë vihet në dispozicion realisht të përkthehet në një mbështetje dhe qytetarët dhe institucionet ta ndjejnë në punën e tyre që pikërisht në sajë të mbështetjes më të mirë financiare, ata mund të realizojnë më mirë perspektivat e tyre, sigurisht edhe të performojnë më mirë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Felaj!

Para se ta marrë fjalën zoti Sula, a mundet zonja Dhëmbi t’i kthejë një përgjigje, se kam përshtypjen që të gjithë jemi të qartë për çështjen e buxhetimit në kuadër të perspektivës gjinore.

Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Mimoza Dhëmbi – Jemi të lumtur që na e bëni këtë pyetje!

Ne kemi një sistem të zhvilluar, mund të them, e kanë vlerësuar edhe institucionet ndërkombëtare, që kemi futur perspektivën gjinore në programet tona buxhetore. Pra, janë disa programe buxhetore, të cilat kanë objektiv gjinor, kanë tregues të matshëm dhe mund të shohësh edhe progresin. Nuk mund ta them në këtë moment sa programe buxhetore janë, por që e kanë perspektivën gjinore si një nga objektivat e matshëm dhe të raportueshëm. Kështu që, ne mund t'ju paraqesim një raport specifik, meqenëse ju jeni pjesë e organizatave të konferencave të ndryshme, për të treguar jo vetëm si janë këta tregues në programe të ndryshme buxhetore, por cili është edhe progresi nga viti në vit, pra sa fonde më shumë alokojmë në programe që kanë objektivin gjinor. Ne e raportojmë shpesh këtë, kështu që mund t'ju paraqesim një raport specifik për këtë pikë.

Në lidhje me dixhitalizimin, dua të them se programi i qeverisjes është i financuar me 1,5 miliardë lekë më shumë nga viti 2021, pra tregon prioritizimin që u kemi bërë programeve të dixhitalizimit në buxhetin e shtetit, pastaj ku përqendrohen është histori pak më e gjatë, janë alokuar tek AKSHI, përveçse ka edhe institucione të tjera, që kanë programe. Për shembull, për policinë do të ketë një program shumë të rëndësishëm prej 1 miliard lekësh, nga të cilat 500 milionë do të jenë tek AKSHI, dhe 5 milionë do të jenë te buxheti i Ministrisë së Brendshme për dixhitalizimin e programeve të Policisë së Shtetit.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Dhëmbi!

Do të ishim të interesuar të kishim një informacion të këtyre raporteve në lidhje me sa zbatohet buxhetimi në kuadër të perspektivës gjinore.

Atëherë, zoti sula, fjala është për ju.

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht, kjo mbledhje e komisionit është shumë e rëndësishme për sa i përket diskutimit të buxhetit për vitin 2022. Unë, pa diskutim, ruaj konsideratën më të lartë për anën profesionale që shfaqin specialistët e Ministrisë së Financave duke pasur parasysh edhe periudhën 2005-2013, ku Ministria e Financave ka pasur specialistët më të mirë. Kjo ministri i ka vënë fre çdo politike, qoftë qeverisjes së djeshme të Partisë Demokratike, qoftë qeverisjes së kësaj maxhorancë.

Kam parasysh këtu abuzimin sesi shpërdorohen fondet e buxhetit të shtetit dhe drejtimin ku shkojnë, se po të kemi parasysh buxheti i shtetit është si buxheti i një familjeje, dhe duhet të shkojë për nevojat më të arsyeshme dhe emergjente që ka shoqëria shqiptare,

sepse buxheti i shtetit është buxheti i qytetarëve, në radhë të parë. Janë qytetarët ata që paguajnë taksat dhe bëjnë të mundur që t'u kthehen investimeve për qytetarët shqiptarë.

Më kujtohet që në vitin 2013 Kryeministri Rama ngrinte me të drejtë, do të thosha, mjaft ashpër borxhet që kishte shteti ynë. Në atë kohë në mos gaboj borxhi lëvizte në shifrat rreth 67-70%, ndërsa sot e dimë të gjithë që borxhi i fshehur ka kaluar 85%-90%. Pra, kemi një shtet që është shteti i borxheve. Ndoshta mund të mos jetë vendi që mund ta përmend, por do t'ju kujtoja më të rinjve që para viteve '90 kishte një shprehje në të gjithë Republikën e Shqipërisë, sepse ishin vitet më të vështira të ekonomisë shqiptare, dhe qarkullonte proverbi për sa i përket zhvillimit të Jugosllavisë, ku Titos i bëhej pyetja duke qenë se Jugosllavia merrte shumë borxhe: "Po merr shumë borxhe. Si do të paguhen ato?" – "Merita ime është që i marr borxhet. Merita e brezave të ardhshëm është t'i lajnë këto borxhe", thoshte Titoja. Edhe ne këtë jemi duke bërë. Merita e Edi Ramës është që merr borxhe sa më shumë për të plotësuar nevojat e veta dhe për të arritur qëllimet e tij, dhe vuajta e brezave të ardhshme është që do t'u ngelen borxhe shumë të mëdha që do t'i paguajnë vit pas viti.

Më vjen shumë keq që ky buxhet është orientuar jo në drejtimet e duhura. Po ta shikosh, gllabërimin më të madh të ky buxhet e kanë PPP-të dhe një pjesë tjetër, siç e tha edhe zonja Çupi, e marrin shpenzimet operative ose të luksit, si mund t'i quajmë.

Kuptohet që Shqipëria nuk është vetëm Tirana, ka edhe qytete të tjera. Të mos bëjmë sikur nuk shikojmë e nuk kuptojmë. Është një gjendje katastrofike sa u përket investimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, flas për zonat rurale kryesisht. Nëse në periudhën 2005-2013 dhe në vitin 2015 nga qeveria e maxhorancës ka pasur investime nëpër rrugët e ish-komunave apo të fshatrave. Sot është për të ardhur keq që në çdo komunë të Republikës së Shqipërisë, në çdo zonë rurale të saj duket sikur nuk jetojnë njerëz, në një kohë që jetojnë njerëz që janë hallexhinj të mëdhenj. Atje nuk ka investime. Ato investime që bëhen për infrastrukturën duhet të bëhen në këto zona rurale, sepse bëjnë të mundur që të rritet mirëqenia e këtyre banorëve, bëjnë të mundur që fermerët t'i sjellin prodhimet e tyre në qytet.

Sot në zonat rurale ka një shqetësim të madh, ku e gjithë mosha e re e lë vendin dhe ikën në emigrim, qoftë në emigrim sezonal, por edhe për të mos u kthyer më. Po ju them që të gjitha fshatrat janë të braktisura dhe është hall i madh për të gjetur punëtorë. Kjo, do të thoni ju, është detyra jonë?! Po, po është detyrë e Ministrisë së Financave, e cila duhet të vendosë fre, sepse, nëse ne nuk i orientojmë politikat e zhvillimit, aty ku ka më shumë nevojë, sigurisht që do të krijohen problematika mjaft të mëdha.

Për sa u përket problemeve të inceneratorëve, unë e përmenda jo pa qëllim, mendoj se Elbasani është në periudhë emergjence. Problemi i plehrave në të gjithë qarkun e Elbasanit është problem i madh. Ky problem bën të mundur që pjesa më e madhe e buxhetit të bashkisë të kalojë te pagesat e firmave që mbledhin plehrat, por ka një problem, sepse koncesionari ka vendosur kosto shumë të larta, që janë të pamundura për t'u përballuar. Duhet gjetur një mënyrë zgjidhjeje.

Folëm edhe për borxhin dhe ashtu siç tha edhe zoti Alibeaj, buxheti i shtetit ka për të paguar fatura shumë të larta sa i përket fitimit të arbitrazhit nga biznese të caktuara, ju e dini fort mirë, sepse është bërë lajtmotiv dhe është për të ardhur keq që vetëm Beçeti ka 120 milionë euro, të cilat duhet t'i marrë nga buxheti i shtetit, duhen paguar duam apo nuk duam ne. Është keqardhje e madhe. Madje ka shumë fatura të tjera që priten të vijnë.

Për sa u përket ish-pronorëve, gjithashtu ka fatura që duhen paguar nga buxheti i shtetit pasi kanë fituar çështjen në Gjykatën e Strasburgut.

Pra, jemi në emergjencë totale në sajë të borxheve që ka ky shtet për të paguar.

U fol edhe për rritjen e fondit për pensionistët. Është për të ardhur keq se ky fond është vetëm 21 milionë euro, që mjafton të bëhet vetëm indeksi i inflacionit për pensionistët, ne të gjithë kemi të afërmit tanë në këtë kategori dhe e dimë që pensionisti nuk arrin të mbyllë as gjysmën e muajit me atë pagesë, se duhet të paguajë ilaçet, ujin, që është rritur, bukën dhe produktet e shportës, që janë rritur të gjitha. Kjo është gjendja pra. Duhet të gjejmë formulën e duhur t'i kompensojmë pensionistët, se me një shtim prej 2-3 mijë lekësh, edhe 20 mijë po t'ua rrisësh përsëri, nuk bëjnë efekt, sepse i dimë si janë çmimet. Me një 50 mijëshe sot nuk blen dot gjërat më elementare në një familje.

U fol edhe për ish-të përndjekurit politikë, që do të ketë një fond prej 8 milionë eurosh. Me këto ritme do të duhen edhe 3 dekada të tjera që të përfundojë fatura sa u përket të përndjekurve politikë.

Për sa i përket borxhit, në vitin 2013 diskutohej që borxhi që shteti shqiptar kishte me personat e tretë ishte 250-300 milionë euro në mos gaboj. Ju ose qeveria deklaroni që borxhi është 150 milionë të tretëve, që për mua është i fshehur, në një kohë që buxheti faktik i KLSH-së ka konstatuar që detyrimet e prapambetura janë 4 herë më të larta, rreth 77 miliardë lekë, 630 milionë euro, konkretisht 14,6 miliardë lekë nga institucionet qendrore dhe vendore, 11,8 miliardë lekë TVSH dhe 50,5 miliardë lekë detyrime të vendimeve të pa ekzekutuara të gjykatave dhe kamat-vonesat potenciale.

Sigurisht, ka shumë për të folur, por unë gjykoj që kjo maxhorancë duhet të jetë jashtëzakonisht e kujdesshme, se në radhë të parë është interesi ose mirëqenia e qytetarëve.

Nëse njerëzit nuk kanë bukë të hanë, pse duhet të flasim për rritje, apo kur Kryeministri flet për satelitët? Kjo është për të ardhur keq! Në fund të fundit ata satelitët e kanë një çmim dhe bëhet fjalë për miliona euro. Dhe që të ngresh satelitët e të quhet krenari për vendin, në një kohë që fshatarët apo shtresat në nevojë vuajnë përditë, kjo është për të ardhur keq.

Sigurisht që opozita ka propozimet e saj dhe një ndër to është edhe propozimi për uljen e TVSH-së për mallrat e shportës. Diskutohet, nga pikëpamja politike dhe thuhet që s'kemi mundësi ta monitorojmë, do të forcojmë oligarkët për sa i përket fitimit që ata mund të arrijnë. Po ju them që efektet financiare nga ulja e TVSH-së për mallrat e shportës nga 20% në 6% që propozojmë ne, parashikohet që efekti në buxhetin e shtetit të jetë 17 miliardë lekë në vit, ndërkohë që vetëm fondet e planifikuara për PPP-të shpenzime luksi në total shkojnë 20 miliardë lekë për vitin 2022. Mjafton të teprojnë këto fonde për të mbuluar efektin financiar të propozimit për uljen e TVSH-së.

Po e përmbledh përfundimisht, kryesorja është jetesa e përditshme e qytetarëve shqiptarë. Në radhë të parë, njerëzit kanë nevojë të mbushin barkun me bukë, se këtu ka arritur puna për shtresa të caktuara. Këtu në Tiranë disave mund t'ju duket e çuditshme një gjë e tillë, por në zonat rurale apo nëpër qytetet e vogla njerëzit mezi mbyllin fundin e muajit. Të mos bëjmë sikur nuk e shikojmë dhe nuk e kuptojmë një gjë të tillë.

Ju faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Sula!

Fjalën e ka zoti Bllako dhe pastaj do të vijojmë me votimin në parim.

Alqi Bllako – Faleminderit, kryetare!

Nuk dua të ripërsëris edhe një herë shifrat që lidhen me mbështetjen që jep ky buxhet për sektorë të ndryshëm, por ajo çka dua të ritheksoj është se buxheti i vitit 2022 është një buxhet i rëndësishëm, që mbështet dhe garanton stabilitetin makro-ekonomik të vendit, mbështet rritjen ekonomike e më së shumti mbështet shtresat në nevojë.

Tani, unë e kuptoj fare mirë se lista e dëshirave të institucioneve apo të deputetëve që përfaqësojnë zona të ndryshme është e pafundme, por në asnjë moment nuk duhet të harrojmë se në çfarë kushtesh jemi dhe nga cilat situata vijmë. Pra, nuk duhet të harrojmë dy goditjet e mëdha që buxheti i shtetit mori si rezultat i tërmetit të vitit 2019 dhe të pandemisë globale, sikundër nuk do harruar që i duhet lënë një hapësirë buxhetore, por edhe fiskale qeverisë shqiptare për një krizë të mundshme energjetike, me të cilën mund të përballemi më ashpër gjatë vitit 2022.

Duke qenë se gjatë diskutimit të shumë kolegëve u shtruan pyetje në lidhje me investime specifike në zonat e tyre, dëshiroj të bëj vetëm një sqarim, që lidhet kryesisht me

praktikën e hartimit të buxheteve. Ne miratojmë sot këtu, jo vetëm në këtë komision, por edhe në komisionet e tjera, tavanet buxhetore që lidhen me funksionet e çdo institucioni. Më pas, bazuar në këto tavane të miratuara, çdo institucion bën detajimet përkatëse me investimet individuale, le të themi.

Ky detajim, sigurisht që ka një rend prioritesh, që fillojnë me financimin e projekteve në vazhdim, sigurisht duke vijuar me financimin e projekteve të reja, duke u nisur nga projektet më të rëndësishme. Në këtë prizëm, pa diskutim që unë do të kisha një kërkesë dhe sugjerim për përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Duke qenë se projekti i detajimit, faza e detajimit të projekteve individuale ndodh kryesisht gjatë muajve janar dhe shkurt, duke pasur në konsideratë gjithë presionin, për shkak të krizave të trashëguara dhe të pritshme që ky buxhet ka, të ishin një monitorues më skrupuloz i projekteve individuale që do të vijnë për miratim nga institucionet përkatëse, pse jo duke bërë në këtë rast dhe një rol avokatie e për të kundërshtuar edhe ato projekte, të cilat mund të mos jenë prioritare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, të bëj edhe një sqarim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Zoti Bllako, vazhdo!

Kolegë, le të dëgjojmë zotin Bllako, ju lutem!

Alqi Bllako – Të bëj edhe një sqarim për sa i përket buxhetit të miratuar, të paktën atë që shikoj në tabelat e vitit 2022, në lidhje me mbështetjen për mbetjet urbane, në Buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka një përgjysmim të këtij buxheti, në krahasim me vitin 2021. Pra, te zëri i investimeve të brendshme, ky buxhet është vetëm 1 miliard lekë, krahasimisht me 2 miliardë lekë që ka qenë në vitin 2021. Kjo për t'iu përgjigjur edhe komentit të zonjës Çupi.

Gjithashtu, sa i përket një tjetër komenti, që zonja Çupi bëri, në mos gabohem, në lidhje me ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar, gjatë vitit 2022 kemi një rritje të ndjeshme, të konsiderueshme, të buxhetit të Ministrisë së Kulturës. Pra, në krahasim me parashikimin fillestar të tavanit buxhetor të kësaj ministrie në vitin 2021 prej 2, 8 miliardë lekësh, kemi një buxhet prej 4, 1 miliardë lekësh, të parashikuar për vitin 2022. Pra, ka një rritje prej 1, 3 miliardë lekësh, ku sigurisht është parashikuar edhe fondi për ndërtimin e teatrit të ri.

Edhe një sqarim tjetër në lidhje me komentin që bëri zoti Sula. Me të drejtë zoti Sula përmendi një vlerë totale prej 52 milionë eurosh, në mos gabohem, që ai i quajti si të destinuar për shpenzime luksi. Është e vërtetë që, nëse e shikon këtë vlerë në tërësi, të bën përshtypje, 52 milionë është një shifër e konsiderueshme, por, nëse këtë shifër do ta ndajmë

dhe do ta detajojmë në institucione individuale, të cilat janë me dhjetëra apo me qindra, do të kuptojmë se realisht bëhet fjalë për shpenzime minimale, të cilat garantojnë operativitetin e këtyre institucioneve gjatë një viti buxhetor.

A ka nevojë për përmirësime? Gjithmonë ka nevojë për përmirësime, dhe pa diskutim që, siç e përmenda, ky është edhe një sugjerim për Ministrinë e Financave, që të jetë më skrupuloze në rishikimin e këtyre detajimeve.

Kështu që, zonja kryetare, unë dua të ftoj kolegët e këtij komisioni, që ta votojmë në parim këtë buxhet, i cili do të garantojë vazhdimin e rritjes ekonomike edhe për një periudhë afatmesme trevjeçare. Pastaj do të kemi mundësi të ndalemi zë për zë për institucionet që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtij komisioni.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Bllako, edhe në cilësinë e relatorit, së bashku me zotin Xhoxhi.

Në fakt, shumë mirë që bëtë një përmbledhje në fund të të gjitha diskutimeve. Besoj se tashmë kemi një ide të qartë sa u takon diskutimeve në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sula, zoti Çyrbja, a mundem?

Atëherë, unë mendoj se këtu kanë mbaruar të gjitha diskutimet tona, kështu që propozoj ta hedhim në votim në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”.

Kush është dakord në parim? 13 pro.

Kush është kundër? 4 kundër.

Atëherë, me 13 vota pro dhe me 4 vota kundër, miratohet në parim projektligji “Për buxhetin e vitit 2022”.

Mbledhja përfundon këtu. Do të njoftoheni për mbledhjen tjetër.

Falënderoj përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për gjithë kontributin e tyre të sotëm. Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA